

INTERVISTË ME HYSNI KRASNIQIN

Prishtinë | Data: 14 mars, 2020

Kohëzgjatja: 122 minuta

Të pranishëm:

- Hysni Krasniqi (I intervistuari)
- Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Erëmirë Krasniqi: A po prezantoheni...

Hysni Krasniqi: Si?

Erëmirë Krasniqi: A po prezantoheni dhe fillojani ku mendoni që është fillimi i juj, qoftë ajo histori familjare, qoftë fillimi juj personal.

Hysni Krasniqi: Po. Fillojmë? Unë jom Hysni Krasniqi, i lindun në Llukar, me të 3. 10. 1942. Përndryshe, jom profesor, kom qenë profesor në të vërtetë në Fakultetin e Arteve, profesor i rregullt, ordinar. Kanë shku faktikisht thirrjet prej fillimit, prej asistentit, ligjërues, docent e deri faktikisht, deri në thirrjen ma të lartë, se s'ka pasë thirrje ma të lartë ma tutje, qajo osht'. Kurse familja jonë, si familje e babës Idriz, i cili ka qenë një prind shumë i mirë, ka qenë i urtë edhe i mençëm. Ai pak ka punu tokë, ai vetëm faktikisht ka pajtu gjaqe, ngatërresa, qito punë i ka kry ma s'shumti.

Erëmirë Krasniqi: Ka qenë si pleqnar i fshatit...

Hysni Krasniqi: Po, ka qenë pleqnar dhe ka qenë si kryeplak i atij fshati. Por, shiqo, ta quajmë fshat, Llukari osht' si vendbanim ma i vjetër se Prishtina, ma i vjetër se Prishtina, si vendbanim po mendoj. Prishtina vonë, në kohën e turkut, atëherë është ndërtu në ato ndërtesat e vjetra. Na kemi qenë një familje, faktikisht e madhe, dhjetë anëtarë të familjes, dhjetë fëmi po du me thonë, dhjetë fëmi, tetë vllazën, ni vlla unë s'e njoh, s'e di se ai moti ka vdek. Ka qenë bebë qysh më tregojnë ata, nuk e di, kurse të shtatit gjallë kemi qenë deri gjatë luftës. Gjatë luftës na kanë shku dy, por edhe ni motër. Kështu që, të pestit jemi gjallë sot e asaj dite, por të shkepun qeshtu si krejt populli shqiptarë në të gjitha anët, nëpër Francë, e nëpër Angli, e nëpër qeshtu. Po, por, kemi qenë një familje, shumë herë kemi pasë harmoni njeni me tjetrin, në përgjithësi në familje.

Nona ka qenë një nonë shumë punëtore, jo që ka qenë punëtore, po e moralshme, e vyshme si bleta, e pastër si bora e malit, u konë e rreptë deri qaty (qesh), po, po ka qenë shumë e rreptë. Ka qenë

shumë... nuk kemi qenë të pasun, kemi qenë të mesëm ashtu të varfun, por osht' interesant, në atë kohë e edhe sot na kanë ndihmu amerikanët. Qysh edhe atëherë na kanë ndihmu neve amerikanët, nuk e di se çfarë lidhje ka qenë ajo, neve na kanë ndihmu amerikanët shumë, krejt asaj ane e krejt Kosovën. Kosova ka qenë, faktikisht ka qënë, s'ka mujt me mbulu faktikisht ushqymjen, por kanë shku anej në Vojvodinë, kanë shku në Vojvodinë për ni kafshatë goje. Kanë punu atëherë, vetëm Vojvodina ka qenë hamari i ish-Jugosllavisë, po, atje kanë shku kanë punu shumë.

Llukari si Llukar osht' ni ngushticë, ni luginë ku rrethohet me male në të djathtë dhe në të majtë, kurse toka e vogël, pak tokë ka, pak ka tokë pjellore, por vegjetacioni është shumë i pasur, osht' ajri i pastër, në përgjithësi osht' vend malor, jo fort malor, por periferi e qytetit sikurse Gërmia, aty lidhet me Gërminë krejt. Kështu që, na s'këm pasë shumë tokë edhe tokën që e kanë punu përpara ata s'kanë pasë as pllug¹ s'kanë pasë, se për traktor, traktori ka qenë diçka (qesh)... kanë punu me përmenda. Ju e dini çka osht' përmenda? Me përmend me pllug, tani dikur dul pllugi. Hajt, hajt tu u zhvillu ekonomia filloi edhe u bo traktori e u bonë plot e edhe sot e asaj dite punojnë me traktor.

Kështu që, një vlla, ai pat studiu, n'fakt pat shku në Shkollën e Mesme të Medicinës në Prizren, po s'kishte mundësi kurqysh hiç me vazhdu shkollën, u kthye, se ai e kryjti Normalen, u kthy tani msus shkoi në Mramor për m'i ndihmu pak prindit, e kështu ka qenë.

Erëmirë Krasniqi: Ma përmendët atë ditë që ju kujtohet pak diçka prej Luftës së Dytë Botërore, fundin.

Hysni Krasniqi: Po Luftën e Dytë Botërore unë e di veç pak si, faktikisht pak si andërr, se shiqo, unë jom i lindun në '41, mu më kanë shkru në '42, tash unë me thonë (qesh)... dokumentat jonë '42. Aty, unë, m'kujtohet si sot, kem pasë oborrit të thurun me avli me gardh, tash e din ti ça osht' avlia edhe gardhi? Avlia osht' e thurrun e për nalt osht' me therra, me therra të plota të trasha. Aty isha edhe me gjyshën, unë veç me gjyshën kom nejt, me nonën e babës edhe gjyshja ma bojke, "Mos u frigo biro, hiç!" Ata i mshojshin, "Dyrtë e oborrit me na çelë", tha. "Ti mos i çel, une i çeli". Shkoi i çeli ajo. Hinën bugartë, se gjermanët shkunë. Neve na lanë do sene, po ato i murrën... na i patëm thonë gjermanëve që leni do sene, "Jo," thojke, "se kur t'i gjojnë bugartë" thojke, "ata krejt kanë m'i bo lllom". Thojke, "Po, p'i marrim, se neve s'po na vyjn, po s'këm qare pa i marrë se shumë ju bojnë zullum".

Kur erdhen bugartë, hinën bugartë në oborrit tonë, m'kujtohet si sot, ai fllaniku ku osht' majtë bylmeti, aty hinën e murrën djathë, djathë murrën. Le që e murrën djathin, i pshtillshin me pelena të fëmijëve edhe ma s'mrami kacat e drunit i kthyn mrapa. Kem pasë hashaf, e peshtil e, krejt i murren me çka ka, shkun, ikën. Ma tutje, e kena pasë një shumë të afërt, gjyshet i kanë pasë vllazën, ai i ka pasë do mjete të punës që ia lanë gjermanët, e ka pasë atë mengelin që i shtrëngon mjetet e dojshin me ia marrë. Ai thojke, "Pse po ma merrni? E kom si mjet pune kto". E kanë pasë ata bombën me veti, ato të

¹ Vegël bujqësore prej hekuri, me plor të madh e të gjerë, që tërhiqet me traktor, me kuaj a me qe për të lëruar tokën ose për të hapur vija kulluese.

dorës, ato si dardha që jonë konë, si grisha edhe ja fërkojshin edhe ia fërkojshin faqet kështu, për me tregu me qitë pare a ku ta di unë. Qito i di si n'mjegulla ashtu i di pak.

Kështu që, neve gjermantë neve asgja s'na kanë prek. Sidomos në oborrin tonë, gjermantë e kanë pasë kuzhinën te na, kanë pasë biskuïta, kanë pasë konzerva, çokollada, që për herë të parë, na s'kemi pasë çokollada atëherë kurrë (qesh). Po ta thom të drejtën, çokollada na dhashin, rrishin aty, plot kanë pasë bicikleta, kanë pasë motora, kuaj kanë pasë, krejt qato i kanë pasë. Pse i kanë pasë te na? Pse vendlindja ka qenë rrëzë malit edhe aty u strehojshin shumë lehtë, qito e di, tjetër nuk di ma tepër. Vetëm që gjermantë m'kujtohet, m'tregon nana ime edhe gjyshja m'tregon, kur ka vdek gjyshi, kur ka vdek gjyshi, se gjyshi jem kishe qenë dymbëdhjetë vjet ushtar i turkut, kish shku për vllazën, për tre vllazën edhe për veti katër. Kështu që, ka tre vjet ka qenë, ushtria ka qenë ka tri vjet në luftë në kohën e turkut, ai ka shku dymbëdhjetë vjet. Kur vdiq baba, gjyshi domethonë, atëherë qysh m'tregon gjyshja, dul njo pesë a s'di sa ushtarë edhe qitën armë përpjetë, përsëndetje për të vdekunin, por edhe sot qitet. E qeshtu ka qenë, qito e di.

Erëmirë Krasniqi: Ku e bonët ju këtë shkollimin fillestar?

Hysni Krasniqi: Shkollimin fillestar, unë e kom kry tetë-vjeçaren në vendlindje, shkolla u thirrë "Ganimete Tërbeshi" atëherë, edhe bile deri vonë s'është thirrë, s'është thirrë "Ganimete Tërbeshi", vonë u thirrë. Ma s'pari unë kom msu në xhami, ku është xhamia e sotit. Ka qenë xhamia dy-katëshe, naltë jonë falë femnat, poshtë burrat. Na jena msu ma s'pari aty. S'ka pasë banka, s'ka pasë karrika as kurgjo hiç, secili e merrke ka ni shkamb ose si postuqi asi lëkure, u ulshim aty. Msusi i parë ka qenë nga Shqipëria, u thirrke Zeqir Zeka. Edhe i kena pasë do dërrasa t'zeza sa fletorja, i kena pasë ato shkumësar që shkrun si laps. Ai spjegojke, na shënojshim, u mushke ajo, fshije tash tjetër, ku me majtë në mend ato, as fletore, as laps, kurgjo s'kena pasë hiç ama bash hiç edhe kështu që na shkojshim qashtu u shkollojshim. E pamë që dikur, populli a e din qysh osht' patriarkal, familjet deri dikun patriarkale, në përgjithësi Kosova ka qenë. Ja nisën m'u anku ata, "Jo s'po kemi ku m'u falë e sene..." e na largun prej atyhit. Nji kushëri i imi, nji kushëri i imi e çeli odën, si shkollë e boni, Nu e ka pasë emrin, Nu.

Erëmirë Krasniqi: Katolik?

Hysni Krasniqi: Jo, jo, Nuhi, shqiptarë mysliman, mysliman. Kështu që, e çeli aty edhe shkojshim na tash. Shkolla e vogël, si furrik, ajri u nxonke, s'mujshim. Hajt, hajt diqysh erdhën kta prej Prishtine, kjo sigurisht qeveria e pa që nuk osht' në rregull gjithë kta nxanës ktu me hi, e marojnë ni shkollë. Atë shkollë tash nuk dijshin vend ku me i gjetë, e bash ai kusheri e la një tokë të veten, një arë, shumë tokë pjellore e la edhe sot e asaj dite osht' shkolla në vendin e tij. A kanë pagu, a s'kanë pagu, nuk e di aty, nuk e di, veç qaty e kena kry shkollën tetë vjet atëhere e kena krye. Shkolla u kry, bile unë e kam pasë kujdestare nji serbe, serbe se na jepke serbisht, kujdestare e kam pasë Zorka Kalašević.

Erëmirë Krasniqi: A keni qenë komuninet i përzim, a ka pasë ma shumë shqiptarë?

Hysni Krasniqi: Jo, jo, jo more krejt shqiptarë jemi konë, ni famlije malazeze u konë larg atje në Makovc, me të thonë të drejtën e vetmja ajo familje ka qenë, qysh ka pikë aty si me pikë prej qiellit, nuk di qysh kanë pikë. Atëherë mbreti i ka qit' në tokat ma pjellore ku ka pasë. Kështu që, unë kom qenë nxënës ku kujdestare të klasës e kena pasë serben (qesh), merre me mend, Zorka Kalašević u thirrke. Pastaj, ne e kryjtëm tetë-vjeçaren. Kur e kreve tetë-vjeçaren atëherë u duhke që m'u regjistru dikund në shkollë të mesme. Çka boj, shkova. M'shkojke pak mu, ashtu se isha një fëmijë shumë i ndigjushëm edhe i vyjm, se e kom pasë, faktikisht kom qenë krahu i djathë i nanës sime, shumë i ndihmojsa nanës.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë punë kishit në atë kohë?

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Çfarë punë t'shpisë ishin në atë kohë, që kishit kaq shumë punë?

Hysni Krasniqi: Po... po, shiqo, nona në përgjithësi e ka majtë bylmetin edhe ka gatue, unë shumë i ndihmojsa, pastrojsha mjellin, ja sitsha mjellin, a besoni ju n'kto? E marrsha ato bukët a din që osht' në ato rubat, në fund e qitsha, e qitsha n'qerep edhe nana e qitke saqin, se u tutke mos po digjna unë edhe i ka pasë mjetet speciale, interesant hala i kom, mjetesh kështu tap me kap, jo mjete palidhje me legraqa e ato, jo, jo special krejt i kom. Kështu që, i ndihmojsa nanës tem me fshi, me la enë, kom pastru enë. Po zaher m'përcjelli edhe fati, tani qashtu edhe kur u martova (qesh)... se te dytë, shoqja në punë, unë në punë. Shiqo u duhke m'u kujdesë aty, femër ka punu edhe ajo, tetë orë bile. Ajo ka punu tetë orë n'punë, unë i kom pasë katër orë n'javë, katër orë në javë msim kom pasë, se ajo ka punu në postë, ka qenë kontrollore para lufte dhe pas lufte. Kështu që, u duhshe me punue, nanës i kom ndihmue shumë, hallall ishalla Zoti ma shkrun sevap (qesh). E qeshtu nanën i kom ndihmu shumë, tepër, ia kom shkurtu drutë e tonat.

Erëmirë Krasniqi: Me kta fëmijët tjerë qysh ka qenë jeta me jetu me ta?

Hysni Krasniqi: Po shiqo (qesh), a e ke pa? Asnjo s'jonë njejtë, asnjo s'jonë njejtë, do shkojshin në bagëti, do shkojshin me punu punë fizike, kopshtin. Një vlla e kena pasë, i madhi, shumë punëtorë ka qenë, i vetmi ai i ka ga nanës sime, ai ka qenë i pastërt, ka qenë punëtorë, i vyjshëm edhe i drejtë. Shumë punëtorë u konë ai, shumë, shumë, shumë. Edhe mu m'vjen shumë keq që ai nejti tre muj n'mal, murr kancerin, shkoi gjatë luftës, qato nuk guxojke me ardhë në shpi aty me ardhë me flejt. Me qito sende kemi qenë aty, kemi pasë probleme shumë të mdhaja. Pastaj unë si e kreve, faktikisht shkova në Shkollën e Mesme Teknike...

Erëmirë Krasniqi: Ktu në Prishtinë?

Hysni Krasniqi: Po, në Prishtinë, në "18 Nëntorin". Aty e kom kry shkollën e mesme serbisht, pos ni tetë-vjeçare e kom kry shqip. Prej shkollës së mesme serbisht, prej fakulltetit serbisht, prej shkollës së

tretë serbisht, krejt në gjuhës serbo-kroate na e kena kry. Por, qajo gjeneratë që e ka kry nëpër, që e kena kry për shembull në Beograd, Zagreb, Lublanë e kanë çelë Universitetin.

Erëmirë Krasniqi: Po, veç të kthehemi prapë, qysh ka qenë Prishtina në të '50-tat kur keni ardhë?

Hysni Krasniqi: Në '50-tat mu m'kujtohen si sot. Ai vendi, ajo rruga jonë që shkon për shembull Prishtinë-Llukar-Makovc-Grashticë, pastaj shkon anej prej Leskovcit në Serbi. Ajo ka qenë rruga deri kur t'hin krejt lloq. S'e di sa ju e dini, ka qenë një binare aty, një binare e trenit që shkojke për Serbi anej, Podujevë, Serbi anej. Kur dilshim në binarë thojshim, "Uff, pshtum", se s'ka lloq aty. Na shpeshherë me ta thonë të drejtën çorapat e lagta i lejsim, t'lagta i veshim, e qeshtu shkollimi u bo te na. S'kem pasë, atëherë edhe këpucë s'ka pasë, ka pasë opinga² të Pirotit, ka pasë opinga që i marojnë prej lëkurës.

Nona jem, rahmet i pastë shpirti, marojke opinga me mrrathë edhe bugarisht, bugarisht kështu thjeshtë kurse me mrrathë i qëndiske, i qëndiske a din çfarë, me t'vërtetë thu se e ka qëndisë ato qaq bukur e bojke, diçka e pabesueshme. Po ta them, nona jem ka qenë shumë shumë punëtore, ajo ka punu edhe n'vek, e mu m'ka lindë arti prej nonës sime. Nona jem m'shtike m'i nda ato cuklat, të kuqen, të bardhen, të zezën, të gjelberten, të verdhen, krejt ishin në kutia t'vogla e i ndajsha unë ato edhe aty m'ka lindë. Më pastaj ka qenë si vend Llukari ka qenë me plot lule nga natyra, vet Zoti i ka falë ato. Marrsha, s'kishim ngjyra, s'kishim ngjyra me ble, e marrsha lulen edhe e trussha në fletë kështu edhe e ngjyrossha, po për Zotin.

Besom që deri vonë i kom pasë ni parë ngjyra t'yndyrshme, kanë qenë ngjyra t'qirit, ngjyra t'qirit m'i patën dhonë kta kur erdhën amerikanët që na çojshin si bakshish, po edhe na tash po çojna a po e sheh? Fëmija jonë po ju çojnë shkollave tjera, shumë mirë. A din sa shpirti po m'dhemb, por po i thom grues, "Çoji sendet ma t'mira, se edhe neve qeshtu dikush na ka ndihmue". Për nder po, qeshtu po i çojmë edhe na.

Erëmirë Krasniqi: A ju kujtohet Prishtina në të '50-tat, kur keni ardhë?

Hysni Krasniqi: Po, se dulem pak prej temës e vërtetë osht' se memorjen hala shumë mirë. Mu m'kujtohet ajo rruga ku shkojke për Leskovc, aty ka qenë një atëherë u thirrë xhymryk me dhonë, xhymrykhane, aty jena hi nëse ti e ki një kroshe vezë, ki me pagu një xhymryk.

Erëmirë Krasniqi: Taksë?

Hysni Krasniqi: Taksë, një lloj i taksës ama xhymryk u thirrë. Qashtu po ta thom, taksë kena pagu aty edhe kanë shku lopë e ku ta di unë çka kanë shku kanë dhonë taksë për me hi n'qytet, me shit mallin, pemë, perime, krejt u dashtë me dhonë taksë aty. Prishtina ka qenë shumë e thjeshtë, unë e di rrugën e Llapit për shembull. Deri vonë kanë qenë tufat me dhenë, me dele dalshin aty, e maj n'men si sot ka

² Këpucë tradicionale të veshura nga shqiptarët në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, Greqi (nga Arvanitasit) dhe fshatrat arbëreshe të Italisë.

pasë stogat me sanë, me kashtë, kanë majtë kafshë aty. Deri vonë, Prishtina vonë osht' pastrue. Po ai ish, ai Gashi, Shefki Gashi, po ai i fundit i ka hekë loptë prej atyhit, i fundit i ka hekë (qesh). Tash kom ndëgju edhe Mramori i kish hjekë, po.

Erëmirë Krasniqi: Çka ka pasë, a mundesh me na përshkru?

Hysni Krasniqi: Shpija orientale prej melles, prej kashtës, drunit, çahma, pallzina, ti e din çka osht' pallzina? Druni i gdhendun kështu edhe ashtu u mshelë, e kanë mush mellë me kashtë. Rrallë najnjo që ka qenë me qerpiq të maxhupve³ që thojnë ata, t'mbulume me qeremide të maxhupit, ka pasë me kashtë, deri vonë ka pasë edhe me kashtë t'mlume. Nuk ka pasë, kurrfarë qendra s'ka pasë. A e din çka, qendra kryesore u konë, ti po e din ku osht' xhamia kryesore, xhamia...?

Erëmirë Krasniqi: Cila, Xhamia e Çarshisë⁴ a Xhamia e Madhe⁵?

Hysni Krasniqi: Xhamia e Çarshisë, jo e Madhja, ajo hala osht'... qe sa jonë tu e bo renovimin, me vjet turp i Zotit osht', ajo xhami osht' ma e vjetra. Qaty ka qenë qendra, ka qenë ni tualet publik, pak ma poshtë kanë qenë fiakerat, aty kanë qenë t'parkum. Kush ka pasë pare kanë shku deri në Gërmi atje, sidomos në Tokbahçe u thirrke atje, në Tokbahçe jonë shku atje m'u fresku, pastaj kur i kanë bo fëmijët synet i kanë çu atje i kanë shetitë aty e nëpër qytet. Kurse në qendër, aty ku osht' Hoteli "Union"⁶, Hoteli "Union" kur t'shkojsh te poshtë, në anën e majtë. Në të djathtën jonë konë ni muri i madh edhe ka qenë "Uzori" u thirrke, ni shitore prej gjilponës e deri te këmisha e votë e ku ta di unë, qaty u konë plot.

Erëmirë Krasniqi: A ka qenë Xhamia e Llokaçit⁷ aty hala a...

Hysni Krasniqi: Cila po mendon?

Erëmirë Krasniqi: E Llokaçit është kjo bash ku osht' "Bozhuri"⁸, bash qaty ka qenë.

Hysni Krasniqi: E "Bozhuri", jo, jo ato e kanë rrxu ato.

Erëmirë Krasniqi: Po e kanë rrxu, e kanë ndërtu hotelin, a po ju kujtohet tash?

³ Term derogativ për komunitetin Rom.

⁴ Xhamia e Çarshisë, Xhamia e Gurit ose Xhamia e Sulltan Muratit (1393) është një monument i trashëgimisë kulturore në Prishtinë, Kosovë.

⁵ Xhamia e Mbretit e njohur edhe si Xhamia e Madhe ose Xhamia e Sulltan Mehmet Fatihut II është në rrugën "Nazim Gafurri" në Prishtinë, Kosovë. U ndërtua me urdhër të Sulltan Mehmedit II në vitin 865 hixhri (1460-61).

⁶ Ish Hotel Unioni është një monument i trashëgimisë kulturore në Prishtinë, Kosovë dhe është ndërtuar në vitin 1927 nën mbikëqyrjen e arkitekt austriak, Andrija Kremer.

⁷ Xhamia e Llokaçit u ndërtua gjatë periudhës 1455-1551, dhe pasiqë gjendej në një pjesë të qytetit që ishte plot me baltë dhe pluhur, qytetarët përdornin një shprehje, "Lokaç, tükür de kaç", që në përkthim ka kuptimin, "Llokaç, pështyj dhe ik".

⁸ Hotel Božur, apo në shqip Bozhur, ishte një pikë referimi në Prishtinë dhe hoteli i parë në qytet. Sot, ajo është shndërruar në Hotel Zvicëran Diamond në Bulevardin Nënë Tereza.

Hysni Krasniqi: Po ka qenë një xhami edhe një kishë u konë.

Erëmirë Krasniqi: Kisha u konë pak ma poshtë.

Hysni Krasniqi: Edhe ni kishë u konë. Shumë bukur, mirë p’e din. Kështu që, ka qenë një mur i madh, krejt pllakatat e filmit qaty jonë konë. Maxhupët kanë qenë me atë samarin, me atë samarin aty kanë pritë kush ka pasë nevojë diçka për to me çu hamall diçka, ata kanë qenë. Bile profesori jem i ndjerë Muslim Mulliqi i ka pasë bo një vepër artistike me hamallin, shumë bukur e ka pasë bo, mrekulli e Zotit u konë ajo. Ajo ka qenë për atë shtet edhe që thojnë “thikë me dy teha”, që do të thotë se ky popull veç hamall osht’, se e maj n’mend unë edhe si student shqiptartë tonë tu i pre sharrë në Beograd me sharrë, drutë tu ia pre, t’u shkarku thëngjill edhe ato i di.

Erëmirë Krasniqi: E ku ka qenë Shkolla Teknike, në të cilën thatë që keni shku në të mesmen?

Hysni Krasniqi: Shkolla Teknike ka qenë ku është sot.

Erëmirë Krasniqi: Po, po, ju a keni shku në Shkollën e Mesme Teknike?

Hysni Krasniqi: Po në Shkollën e Mesme Teknike kom shku unë, po. Shkolla e Mesme Teknike ku është sot, ku osht’ bo tash gjimnaz edhe ato e kanë bo “Sami Frashëri” edhe ato e kanë bo, tash dy gjimnaze jonë bo. Eh, qaty ka qenë, bile shkollë, u konë shkolla e vjetër, ajo ma s’pari ka qenë. A din çka ka qenë? Banim për nxansat e Normales, konvikt.

Erëmirë Krasniqi: Aha, ku osht’ Arkivi i Qytetit sot.

Hysni Krasniqi: Konvikt ka qenë, qaty ka qenë.

Erëmirë Krasniqi: Qysh kenë qato vjet e shkollës t’mesme, a ka pasë shumë njerëz të arsimum n’atë kohë, a qysh ka qenë situata?

Hysni Krasniqi: Pa shiqo, mu m’kujtohet si sot, kanë pasë të arsimum edhe kanë pasë jo të arsimum.

Erëmirë Krasniqi: Po, po qysh ka qenë...

Hysni Krasniqi: Në përgjithësi kanë qenë të arsimum.

Erëmirë Krasniqi: A ka qenë fillimi i arsimimit atëherë?

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: A ka qenë fillimi i arsimimit të popullatës...

Hysni Krasniqi: Jo, jo, përpara ka qenë, jo edhe përpara, jo me gjeneratën teme. Veç po thom, msusi i parë i imi ka qenë Zeqir Zeka nga Shqipëria, ai ka qenë. Po tani u shkollun shumë, po agronomi i parë

ka qenë në Kosovë ka qenë kushërini im, është djali i axhës, Shemsi Krasniqi e ka pasë emrin, gjatë luftës e vranë, qito e di. Pastaj ka qenë Ibushi, shumë, faktikisht një person që ka ditë shumëçka. Fejzë Krasniqi ka qenë matematicient edhe fizicient i mrekullueshëm, Fejzë Krasniqi. Zeqir Krasniqi, ai ka dhonë frangjisht, po nuk e ka njoft frangjishten, as vet s'e ka njoft frangjishten, po e di edhe vet, po ka dhonë qito.

Masi që e kreu unë, faktikisht pastaj shkollën e mesme e pashë që, m'u dokë që diçka nuk o në rregull me mu, pak osht' kjo. Unë shkova dhe tu i bo ushtrimet e shkollës t'mesme teknike për me bo mjete t'punës me punu, bile e kom edhe ktu vizatimin e shihni edhe vet vizatimin teknik kur e kom maru mjetin edhe një inxhinjer m'pa, vizatojsja unë nëpër drrasa aty.

Erëmirë Krasniqi: Ku punojshe?

Hysni Krasniqi: Në "Ramiz Sadik"⁹ kom qenë, në "Ramiz Sadik". Edhe po m'thotë njoni, po m'thotë, "Çka kërkon ti ktu more, pse nuk shkon ti në vend aty ku e ki tonin?" Ai vet, po, edhe shkoj unë në Shkollën e Lartë të Pedagogjisë konkuroj. Por, une thashë, para kësaj mu m'ka zbulu një Xhemail Xhema, ai ka qenë, s'di çka u konë a profesor a, ai ka dhonë art, ka dhonë edhe bazat e arsimit teknik, te dyjat i ka dhonë. Ai mu ma s'pari m'ka zbulu.

Pastaj shkova siç thashë në Shkollën e Mesme Teknike, prej aty në "Ramiz Sadik" punëtorë, u kry se i kualifikum gjoja se, atëherë qashtu shkojshin. Edhe unë, m'tha ai inxhinjeri "Shko more, hiq prej ktuhit, s'je për ktu ti". Shkova unë drejt atje... kur hina në provim, dhashë provimin me sukses, me sukses dhashë provimin, se atëherë ishte edhe me katër vite edhe me tri vite, po mujshe vetëm po u duhke me hi n'provim pranus. M'pranunë, ia fillova, Shkollën e Lartë të Pedagogjisë e kreu.

Erëmirë Krasniqi: Të artit?

Hysni Krasniqi: Të artit, po. Të Artit Figurativ, po. Pikturën ma ka dhonë Muslim Mulliqi i ndjeri, grafikën Gjelosh Gjokaj. Unë u përcaktova për grafikë. Pastaj, n'atë kohë aty ish '63-'64, se në '65-tën unë veç e kreu. Aty faktikisht unë i kreu ato, por fillova me shku në vendlindje, masi që e kreu në '66-tën, në '65-tën e kreu, në '66-tën shkova në vendlindje me dhonë msim. Aty ma dhanë, dihet artin po, po plus ma dhanë bazat e arsimit tektik edhe i dhashë shumë mirë, kesh shumë i kënaqun bile me to. Edhe vetë profesorat kanë qenë të kënaqun edhe nxanësat, se mësojshin shumëçka, se dijsa shumë gjana edhe me ta thonë të drejtën politenika ta jep nifare diapazoni për jetë. Unë në shpinë teme shpeshherë, rrallë që thërras naj mjeshtër, vet i punoj do sene, veç në elektricitet s'i shti durtë aty, në elektricitet s'ka zo, s'ka ngjyrë, të fshin (qesh). E qeshtu osht' puna. Masi që i kreu ato e bona një pauzë.

Erëmirë Krasniqi: Sa dhatë msim, një vjet, dy?

Hysni Krasniqi: Urdhno?

⁹ Ndërmarrje shtetërore e ndërtimit.

Erëmirë Krasniqi: Sa...

Hysni Krasniqi: Vetëm një vit, vetëm një vit, një vit. Pastaj u lajmrin kta prej qeverisë që do ta bojnë një fushë sportive për DIF-in, “Kush po don n’akcion?” Unë thojsha, “Për Kosovë vij, për tjetërkun jo”, kurrë s’jom shku. Kur shkum atje, nejtëm një muj ditë edhe m’shpallën si sulmus, na dhanë shpërblime e sene ku ta di une na dhanë, po...

Erëmirë Krasniqi: Ku u mbajt?

Hysni Krasniqi: Në Prishtinë, në Prishtinë, Prishtinë, ajo fusha e sportit e DIF-it, na e kena punu si brigaderë, po kena nejt, bile ka qenë edhe kjo Vjosa Nimanin. Ndoshta keni ndëgju për Vjosa Nimanin, ka qenë një femër shumë, ajo juriste osht’ tash, e ka kry si juriste, kemi qenë bashkë me to e shumë të tjerë. Edhe kështu që, atëherë e pashë që pak osht’ kjo edhe s’isha i kënaqun me vetëveten, s’isha i kënaqun. T’i përgatita unë punimet edhe drejt në Beograd, drejt në Beograd. Por, ai kuadri i Beogradit shpeshherë dhake mësim edhe në Prishtinë e ata tash i zbulojshin, i prekshin pak talentat, kush osht’ talent, kush mundet me vazhdu, kush nuk mundet.

Edhe mu m’caktun, “Veç duhet me marrë biletë edhe me shku ti”. Morra punimet, se atje ma s’pari, ti i merrshe punimet, i përgatitshe punimet edhe pa emër, pa mbiemër, veç një shifër. Unë shifrën e kom pasë “Teuta” po ehh, shqiptar bre, “Teuta”. Edhe punimet e mija i pranojnë, emri “Teuta” thotë osht’ i pranum për me hi n’provim. Hina në provim, e dhashë provimin, u kry.

Erdha në Prishtinë thashë, “Babë e kom kry provimin, çka me bo?” Tha, “More babë s’po di”, se s’ka pasë kurfarrë të ardhuna. Shkum në komunë me lyp një bursë, ishte nifarë Xheladin Topxhiu, kurrë s’e harroj. Thashë, “More Zoti qeshtu, qeshtu...” me babën shkum, “M’kanë pranë në Akademinë e Arteve” thashë, “për me vazhdu mësimet”. “A e din çka?” Tha, “Ne s’na duhet për Akademi”. Qe çfarë kuadri e kena pasë na. S’kisha çka me bisedu mo, e lash. Kur unë shkova, i kom pasë dy vllazën në Francë atëherë, një vlla m’ndihmojkë shumë, m’ndihmojke shumë.

Erëmirë Krasniqi: Qysh shkun vllaznit në Francë, a ka qenë e zakonshme?

Hysni Krasniqi: Atëherë a?

Erëmirë Krasniqi: Me lëvizë, po.

Hysni Krasniqi: Veç në Amerikë s’ki mujt me shku ti, veç ndëgjom, me pasaportë të ish-Jugosllavisë pos në Amerikë s’ki mujt me shku, ku ki dashtë ki shku.

Erëmirë Krasniqi: Me migru po mendoj, a ka qenë e zakonshme?

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: A ka qenë e zakonshme me migru në atë kohë?

Hysni Krasniqi: Po, qysh jo. Ndigjo vjazo, ktu nuk mujshe m'u punësu ti, u punësojshin ata që jonë në funksion, ata ti e din kush jonë. Mos t'i përmendi me emër me mbiemër, mos t'hijmë anej... vetëm ata kanë, asnjë s'ka qenë i papunësuar, krejt t'punësuar kanë qenë ata. Fabrikat ma rantabile, të gjitha aty kanë qenë, krejt, krejt komplet kanë qenë, merre ti shiqoje, me Fabrikë të Tekstilit, me Fabrikë të Drunit, me Fabrikë të kryne... Elektromotorrave, të Langjeve, krejt aty jonë kanë. Në Prishtinë vonë jonë kanë, vonë çka ka pasë një Fabrikë e Tekstilit, ajo qysh u thirrke kjo...

Erëmirë Krasniqi: Vartex?

Hysni Krasniqi: Jo, jo "Vartex", kjo tjetër... Thjerrtorja, "Thjerrtorja Predionica" ku e ka landën e parë për shembull në Kosovë, duhet me marrë prej Arabie dikund atje, pamukin. Përveç tjera ktyne seneve, mos t'i hij andej se çka di unë... kështu që, kështu ka qenë puna.

Erëmirë Krasniqi: Ju vllaun e kishit në Francë, tash ai ju ndihmojke?

Hysni Krasniqi: Vllau në Francë, ai më ndihmojke shumë, shumë m'ndihmojke. Edhe tash po shkoj p'e lexoj aty në shpallje në Akademi të Arteve, thotë që mund me konkuru studenti për kreditë, *republički krediti* thojke, *republički krediti*, kreditë e republikës, po thashë tybe e lo, pse jo? Po ju tregoj kushtet çfare i kom, m'i dhanë. Po shkrujke aty, "Nëse ti i jep provimet me kohë, nuk kthen kurgjo, nëse s'i jep duhet m'i kthy". Edhe unë punojsha, natë e ditë punojsha me i dhonë provimet. Hina me kohë, po kaniherë çalojshim një provim s'mujshim niherë po t'dytën, veç kryesorja mrena viti u kryjke, qashtu.

Tani, ia fillova, me fillu punime me punu, grafika. Shpërblimin e parë e morra për "Uresat e Vitit të Ri" në Akademi të Arteve, shpërblimin e parë për "4 Majin" për studenta që osht' e morra t'parin, ia nisa me shitë grafika edhe palojsja, besa ja fillova me kursy pare edhe në bankë. Po, po, jom mësu qysh si studentë, duhanin s'e pijsha, alkoolin s'e pijsha, duhanin s'e kom pi kurrë e as s'e pi. E kështu që, qito gjana.

Pjesa e Dytë

Erëmirë Krasniqi: Qysh ke Beogradi për juve? A ke ndryshim i madh?

Hysni Krasniqi: Po, shiqo Beogradi, shiqo, qyteti i madh kur t'shkojsh prej një province nëse ti s'ki fuqi, karakter të fortë, të absorbon, të absorbon. Por, unë e kom pasë qëllimin, e kom ditë për çka po shkoj, le të jetë çfarëdo, çfarëdo, unë shumë shpejt u adaptojsha. Jom adaptu në të gjitha rregullat e studimeve që jonë kanë, se u duhke herët m'u çu në mëngjes, me marrë çkado diçka, naj kifle e marrshim, naj virshlle qaty me semf edhe bllokun në sjetull, në tramvaj edhe shkojshim. Puškinova e thirrshim, Puškinovani thirret, atje i kemi pasë ateletë midis malit, po për nder po. Aty shkojshim, punojshim për nder, dej na ardhke ai portieri aty, "A po dilni bre se boll". I blejshim kajherë diçka, naj

napolitankë a diçka i blejshim, naj birrë a, me na lonë me punue, na lake (qesh). Ça ki me bo, gjithkund rryshfeti osht', e qeshtu.

Atëherë unë kom punu shumë, shumë kom punu, të gjitha teknikat e grafikës i kom punu, prej drugdhendjes, linogdhendje, linogravurë, bakërskkrirjet, akuatintës, meztotintën, sa që kena punu edhe stereografi edhe litografi. Lito në guri osht' teknika ma e vështirë osht', punohet n'guri, vizatohet, por gurin duhet me përgatitë mirë për me vizatu. Kështu ka qenë në Akademi të Arteve n'atë kohë me ta thonë të drejtën, na s'kena pasë problem. Unë për veti ni herë me ni student kom pasë, ish konë sherran, ia nisi pak, i thashë, "Shiqo, unë me ty s'kom punë. Ti që je i ngarkum, shko ti me ata bisedo, me mu s'ki çka bisedon. Largomu, largomu!" P'i tregoj profesorit tem, ka qenë Boško Karanović¹⁰, shumë njeri i mirë u konë. E thërret ato, tha, "Qy çka po po thom, me sy s'guxon me kqyr kto. A e ki t'kjartë?" Edhe kurrë mo s'kom pasë problem, kurrë mo s'kom pasë problem me askond hiç, *tak* {onomatope}.

Profesorat jonë sjellë mirë, seriozisht po ta thom. E kena pasë ni profesor i cili i ka njoftë shtatë gjuhë t'huja, na dhake Historinë e Artit ai. Kur ia filloi me spjegu historinë për kombet, se e kishin aty cili komb ma i vjetër, "Populli shqipëtar" tha, "*Albanski narod je najstariji narod*" [Populli shqiptar është populli më i vjetër]. Veç jonë kthy krejt studentat drejt meje me më kqyr, unë gjakftohtë, e kqyrsha ato temën, e disha. Kështu ka qenë puna, kemi dhonë provimet, kemi mësu.

Erëmirë Krasniqi: A shkojshit nëpër ekspozita? A e shfrytëzojshit atë jetën kulturore që ndodhke atje?

Hysni Krasniqi: Po shiqo, aty osht' Muze, Muze Bashkëkohor¹¹, osht' ka Sava anej. Aty ki artin, gjithçka, gjithçka ki. E ki Muzeun Popullor në Beograd osht' afër Puškinova, kësaj Knez Mihajlova, aty osht', jom shku shpesh. Pse shkojsha shpesh? Pse pajsha shumë gjana ilire, shumë gjana ilire ka, por neve na i kanë vjedhë, kryesoret na i kanë vjedhë kta. Nuk po mujnë kta kurgjo me bo, se s'kanë aftësi. Ndigjo, ni pemë që ka lindë në tokë duhet ktu me ardhë ajo, ktu, ajo është ndërta ktu, ktu u maru ai popull. Na jemi popull i vjetër.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë koleksioni kish ai Muze?

Hysni Krasniqi: Prej unazave, prej skulpturave të vogla, mini-skulptura të vogla, gjithçka, gjithçka ka pasë, qelibare ato krejt të tokës tonë, krejt. Unë i shiqojsha, po s'ki çka bon aty me i shiqu. Në Muze, veç ndigjo, në Muzeun Bashkëkohor Popullor aty ka ardhë prej Altamirës¹² veprat, prej Altamirës, me

¹⁰ Boško Karanović, (1924 - 2009), ishte një nga themeluesit e grafikës moderne në Jugosllavi në fund të viteve të '40-ta dhe në fillim të viteve të '50-ta.

¹¹ Muzeu i Artit Bashkëkohor ndodhet në Beograd, Serbi. Ajo u themelua në vitin 1958 si Galeria Moderne.

¹² Shpella e Altamirës ndodhet afër qytetit historik të Santillana del Mar në Cantabria, Spanjë. Është i njohur për artin parahistorik të shpellës që paraqet vizatime qymyrguri dhe piktura polikrome të faunës lokale bashkëkohore dhe duarve të njeriut.

Picasso¹³, me Van Gogh¹⁴, me Rembrandt¹⁵, krejt piktorët ma eminent botëror, të gjithë aty i kanë pru edhe jo kështu reproduksione, origjinale. Po a e din ti çfarë sigurimi ka pasë aty kur ardhshin ato? Krejt në tona anët të armatosun deri sa hishin mrenda, kur hishin mrenda aty. Të gjitha i kom pa unë, megjithëse unë në Luvër¹⁶ i kom pa, kom qenë shpesh në Luvër në Paris, kom qenë në Londër, i kom pa të gjitha ato unë, origjinalet i kom pa.

Kështu që, po du me thonë, sa i përket Ballkanit ka qenë Meka e kulturës Beogradi, e tash Meka e shovenizmit është Beogradi, m'vjen shumë keq kto me thonë. Pse? Çka ka pasë aty kulturë, kom shku në balet, kom shku me pa vallëzim, kom shku me pa koncerte të ndryshme, opera me shokë, me shoqe shkojshim, se na s'pagujshim kurgjo, pjesët teatrale, veç e tregojshim indeksin që jemi studenta të Akademisë, pse ata janë ma t'urtë, ma t'sjellshmit aty kena pa, t'gjitha i kena pa komplet.

Atëherë ka qenë Bekim Fehmiu, ka qenë Faruk Begolli, të dytë artistat ma t'njohun pothuajse kanë qenë shqiptarë në Beograd. Na u mburrshim me ata, për Zotin, po. Qeshtu ka qenë Beogradi. Kemi pasë ushqimet, ka qenë ajo menza e pestë u thirrke... në Knez Mihajlova, po. Pastaj kur e kryva faktikisht Akademinë, unë e kom kry Akademinë e Arteve në '69-tën, në '69-shin.

Erëmirë Krasniqi: A ju nxonën ato protestat e '68-tës aty?

Hysni Krasniqi: Po. Unë me dorë temën e kom shkru midis Knez Mihajlova, me brushë temën shqip *trak trak trak* {onomatope}...

Erëmirë Krasniqi: Çka shkrujtët?

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Çka shkrujtët?

Hysni Krasniqi: Shkrujshim a...

Erëmirë Krasniqi: Po, çka ke sllogani?

Hysni Krasniqi: "Dojmë Liri" thojshim, "Pavarësi" (qesh), kush e lexojke ato, kallabllak, hallakam qeshtu, hallakam shkojke aty krejt, po për Zotin qeshtu, e vërtetë osht'.

Erëmirë Krasniqi: E sa zgjati?

¹³ Pablo Ruiz Picasso (1881-1973) ishte një piktor spanjoll, skulptor, krijues shtypshkronje, qeramik, stilist, poet dhe dramaturg që kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij të rritur në Francë.

¹⁴ Vincent Willem van Gogh (1853-1890) ishte një piktor hollandez i pas-impresionizmit që është ndër figurat më të famshme dhe me ndikim në historinë e artit perëndimor.

¹⁵ Rembrandt Harmenszoon van Rijn (1606-1669) ishte një dramaturg, piktor dhe një nga krijuesit më të mëdhenj vizuel hollandez.

¹⁶ *Louvre*, Muzeu i Luvrit (1793), është një nga muzetë më të madhenj në botë të artit dhe monumentit historik në Paris, Francë.

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Sa zgjatën qato protesta?

Hysni Krasniqi: Po kanë zgjatë nja ni javë ditë, kanë zgjatë tepër. Unë, bile m'lashin aty me disa shokë bash në sekretariat të Akademisë, me telefon me thirrë mos po thërret dikush {kollitet}. Aty kena nejt disa. Aty na bishin ka ni sendviq qashtu sa me majt shpirtin, qeshtu ka qenë. U konë Halil Muhaxheri, u konë Esat Valla, u konë Bashkim Paloja, qita. I kom fotografitë i shifni, krejt i kom (qesh). E qeshtu ka qenë.

Erëmirë Krasniqi: Kur u kthyt në '69-tën mandej...

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Kur diplomutë u kthyt në '69-tën në Kosovë...

Hysni Krasniqi: Na në '69-shin u kthym ktu, po kur u bonë demonstratat, t'kujtohet u konë në '68-shin, a t'kujtohet?

Erëmirë Krasniqi: Shumë ma e re jom (qesh).

Hysni Krasniqi: Në '68-shin na e kena ditë që po bohen demonstratat.

Erëmirë Krasniqi: Ka pasë edhe ktu, e di.

Hysni Krasniqi: Ktu në '68-shin, veç ndëgjom, prej Beogradit kena ardhë edhe jena ardhë ktu para Teatrit, ky Pushkollli folke për... thojke, "Liri, Demokraci, Republikë" ose republikë e lypshim, flamurin e kërkujshim. Aty ka pasë, tollovi e madhe u konë. Para "Avallës", a e din ku osht' "Avalla"? Para "Avallës" vllaun ma kanë plagos prej atyne ndërtesave, krejt të shkijeve¹⁷ jonë konë ato nalt, a t'kujtohet? Se ato kanë thonë të xehtarëve, prej atyhit e kanë plagos vllaun edhe veç kur m'kanë thonë, "Hysni qeshtu qeshtu vllaun ta kanë plagos". E murrëm, s'kishim ku me, nuk guxojsim ku me çu, veç e pamë që s'osht' shumë serioz. Sot e asaj dite e ka plumin atje, në kofshë ktu {tregon me dorë}.

Erëmirë Krasniqi: E pse dulët ju? A e kishit të kjartë?

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: A e kishit të kjartë politikisht pse po dilni në protesta?

Hysni Krasniqi: Po na e dishim, qysh s'e dishim. Na e dishim shumë mirë. Aty folshin gjithçka, kanë organizu rustë e ku ta di, po s'osht' e vërtetë, na e kemi lyp qito që e kemi ne sot, qito e kena lyp na. Vllaun e çunë tani masanej te mjektë te ni shqiptar, e kontrollunë, inçizimet, ato. Thanë, "Nuk është

¹⁷ Term derogativ për komunitetin Serb.

rrezik, ai është pshtjellë me vjam, se me hi me brisk aty fell osht', mundet me pre naj tetivë a diçka", e lanë qashtu, qashtu po. Qeshtu osht' puna e...

Erëmirë Krasniqi: E ktu sa zgjatën? Domethonë, ju keni ardhë...

Hysni Krasniqi: Po apet, veç dëgjo. Prej '68-shit kurrë rehat s'kena qenë na. A beson që prej '88-shit...

Erëmirë Krasniqi: '68-shit.

Hysni Krasniqi: Në të vërtetë prej '68-shit, m'fal. Prej '68-shit kurrë Prishtina, as Kosova s'u konë rahat, gjithë ka qenë në tension, gjithë kemi qenë në tension. Na majshin mbledhje të partisë, se shiqo, ti s'ki pasë qare pa u konë në parti. Nëse ti s'je në parti, as s'mujshe me hi n'punë, as s'mujshe me marrë banesë, kurrfarë beneficimesh. Na majshin aty gjonë dynjenë, veç i folshin, veç i përsëritshin fjaltë, veç me të majtë me t'demoralizu n'shpirtë, me t'demoralizu deri n'mëngjes. Bile u pata bo nervoz ni mbledhje, thashë, "Kqyrni, a bon bre ju bina shtretërit qitu? Bile, t'rrijmë, bile t'flejmë". Ja nisën e po keshin ata, të Komitetit ardhshin tyrlifare ka pasë aty. Qeshtu ka qenë.

Masi që e kreve ato u punësova, u punësova, osht' punë shumë e gjatë me ju tregu kur jom punësu në Akademi të Arteve...

Erëmirë Krasniqi: Po, pse jo, kallxonani se me siguri është edhe fillimi i universitetit...

Hysni Krasniqi: Po ma s'pari kom punu në gjimnaz unë, prej '70-shit, prej '70-shit kom punu në gjimnaz deri në '74-shin.

Erëmirë Krasniqi: Në cilin gjimnaz, m'fal?

Hysni Krasniqi: "Ivo Lola Ibar", "Sami Frashëri" tash. Unë po thom qysh u konë, tash s'muj... qysh ka qenë, qashtu e ka pasë emrin. Aty kom punu katër vite. Mas katër vite u çelë drejtimi jem në Akademi të Arteve ktu në Prishtinë, konkurova, m'pranun. M'pranun ma s'pari si ligjërues, po s'isha unë i tyne, s'isha në atë grupin e tyne, unë që... Ai Syria Pupovci ka qenë përfaqësues në formimin e Akademisë të Arteve edhe e anulun konkursin. Edhe apet p'e lypin tash ni asistent, për inati unë asistent lypa. I murren dy vetë, njonin prej Peje, njonin prej Gjakove (qesh) edhe i çunë në Sarajevë me dhonë provimin pranun ata atje. I shtini njësimet në litografi, litografia, ajo kanë qenë sikur me i thonë qitash ni fillestarit, "Hypi, grahi aeroplanit", të dytë kanë ra. Dytë kanë ra, jonë kthye, janë kthy në Prishtinë. E kanë pasë pushtetin n'dorë, kanë fillu prapë ligjërues kanë punu, unë asistent. Asistent i kërkujt s'kom qenë, kom dhonë nënshkrime, kom dhonë nota, asistent i kërkujt. Kom marrë rrogën e asistentit, a kom punu punën e ligjëruesit. Qeshtu ka qenë. I kom biltenat krejt që doni, të gjithë, ja u bi tonat me pa veç... ç'a t'i bon, s'ki çka i bon. Shiqo, duhet me luftu diçka që mundesh me bo, që e sheh që osht' muri i fortë, veç shiqoje murin kur do të rrxohet ni ditë edhe u rrxue. Qeshtu ka qenë puna e tyne, po për nder.

Erëmirë Krasniqi: Sa gjatë keni punu si asistent?

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Sa gjatë keni punu si asistent?

Hysni Krasniqi: Po kom punu gati, se osht' e parapame çdo tri vjet... nja shtatë-tetë vjet, po. I kom krejt dokumentat aty e shihni edhe vet, ça t'i bojsh.

Erëmirë Krasniqi: Mandej qysh, qysh e...

Hysni Krasniqi: Mandej, pastaj erdhi ni dekan, Fadil Hysa. A keni digju për to? Regjisor është shumë i mirë.

Erëmirë Krasniqi: Po

Hysni Krasniqi: U bo dekan ai edhe e merr ai dosjen tem. E merr, e shiqon. Ai ka qenë nxanës i imi, i kom dhonë në Ferizaj, kom qenë bursist i Ferizajit kom qenë unë. Edhe thotë, "Çka u bo Hysni?" I thashë, "Pyti kta". Edhe meniherë shpall titullin me qenë unë docent, docent, meniherë docent. Prej atyhit, prej docentit ordinar, inordinar edhe vazhdun titujt pa kurrfarë problemi. Se ti nuk mundesh me marrë titull pa pasë ekspozita, pa pasë merita, pa shkru dikush i huji, me shkru. Tash as nuk shkrun kërkush, as nuk bojnë ekspozita. Veç me t'njofshëm.

Erëmirë Krasniqi: A bojshit ju ekspozita në atë kohë? A kishit mundësi?

Hysni Krasni: Urno, po...

Erëmirë Krasniqi: A kishit mundësi me ekspozu, se Galeria ndodhë në '79-tën. A po m'kallxon çfarë hapësira ekspozuse...

Hysni Krasniqi: Në '79-shin?

Erëmirë Krasniqi: Po, Galeria e Arteve në "Boro Ramiz"¹⁸ në '79-tën u hapë, po para kësaj, para "Boro Ramizit" çka ka ndodhë?

Hysni Krasniqi: Para "Boro Ramizit"? Na kena hapë, normal ka qenë.

Erëmirë Krasniqi: Ku, në çfarë hapësira?

Hysni Krasniqi: Nëpër, kështu nëpër tjera qytete...

Erëmirë Krasniqi: A kish nëpër tjera qytete galeri a?

¹⁸ Pallati i Rinisë dhe Sporteve është një godinë me shumë destinime, e cila ndodhet në Prishtinë, Kosovë. Kompleksi mbaroi në vitin 1977. Fillimisht u quajt "Boro dhe Ramizi" pas dy Partizanëve Jugosllavë të Luftës së Dytë Botërore dhe Heronjve të Popullit të Jugosllavisë, Boro Vukmirovic dhe Ramiz Sadiku për të simbolizuar vëllazërimin dhe unitetin midis serbëve dhe shqiptarëve.

Hysni Krasniqi: Po, ka pasë. Kanë pasë në Ferizaj, ka pasë në Pejë, ka pasë në Gjakovë, ka pasë në Gjiilan, po edhe ktu ka pasë, private ka pasë. Ka qenë një galeri e vogël ka qenë, m'kujtohet si sot ku osht' Domi i Armatës, ajo ka qenë Ministria e Kulturës poshtë.

Erëmirë Krasniqi: BVI¹⁹-ja.

Hysni Krasniqi: E BVI, e qajo, qashtu BVI tash po ndrrohen me siguri tjera, qashtu ka qenë ajo. Qaty kom hapë ekspozitë edhe unë aty të pavarun. Ekspozitë kom pasë edhe gjatë, si brigadier, kjo ka qenë në '65-shin, '65-'66-tën mos gabofsha. Aty kom pasë, bile ka pasë shkru nifarë si e pat emrin, ni shkrimtar shumë shumë i mirë u konë ai, po p'i harroj emrin me ta thonë të drejtën, qitash s'po më bjen n'men. Patë shkru ai ma s'pari ka shkru për mue, po. Vehap a s'di qysh e ka pasë.

Erëmirë Krasniqi: Vehap Shita?

Hysni Krasniqi: Jo, jo, Vehap Shitën e njoh. Edhe Vehap Shita ka shkru për mu, ni katallog ma ka pasë përkthi ai, e ka pasë bo përkthimin se ai ka qenë përkthyes shumë i mirë. Djalin e tij e kom pasë nrxanës edhe student, student në, kom dhonë une edhe në Fakultetin Teknik të Ndërtimtarisë, se ata vizatim të lirë. Kom dhonë nja disa vjet, e pash që s'ka llogari, s'u pagujshim mirë.

Erëmirë Krasniqi: E çka pikturojshit? Qysh i konceptojshit punët e juja?

Hysni Krasniqi: Ku?

Erëmirë Krasniqi: N'qat kohë po m'intereson punimet e juja kur i pikturojshit, kur i punojshit grafikat e para...

Hysni Krasniqi: Shiqo...

Erëmirë Krasniqi: A çfarë tema i trajtojshit?

Hysni Krasniqi: Ka qenë Shoqata e Artistëve Figurativë. E kemi pasë sekretarin që e ka përcjellë faktikisht drejtësinë rilike e ka përcjellë. Shoqata, kryetari i shoqatës ka qenë Kadrush Rama, ka qenë plot, Hivzi Muharremi e plot kanë qenë edhe ata na thirrshin me hapë ekspozitën. Na i çojshim punimet, ata i caktojshin sa punime m'i çu, dy, tri, katër, pesë, dhjetë, varet. Qashtu i kena çu në krejt botën, s'ka vend që s'i kena ekspozu na, ama kolektivisht. Dikush kush ka dashtë, kush ka mujtë, ka punu edhe vet në mënyrë individuale, ekspozitë individuale. Unë kom pasë në Paris, kom pasë në Londër, kom pasë në Paris tri herë, kom pasë në Nish, kom pasë në Zagreb, kom pasë në Lublanë, s'di sa vende kom pasë unë ekspozitë individuale. E kemi biografinë ktu kur t'dojmë.

Erëmirë Krasniqi: E tregomni ju ma shumë detaje, se biografitë janë kogja... por qysh ka qenë jeta kulturore në Kosovë?

¹⁹ Byroja e Interesave Vetëqeverisëse, tani Ndërmarrja Publike e Strehimit në Prishtinë.

Hysni Krasniqi: Jeta kulturore, shiqo ti nuk ki mujt për shembull me u regjistru në Akademinë, në Shoqatë pa e pasë ma s'pari Akademinë edhe pa pasë punime, por ka pasë edhe raste që s'ka pasë Akademi të Arteve, ama ka qenë i talentum, plot ka edhe asi. Ka qenë i talentum, osht' formu komisioni, komisioni ekspertëve kanë pranë edhe ai është hy. Ka pasë plot asi.

Erëmirë Krasniqi: Ka qenë aktiv...

Hysni Krasniqi: Ka qenë aktiv edhe i talentum, ka pasë merita, ka pasë merita që ka mujt me qenë edhe ky artist i pavarun. Me ta thonë të drejtën, në atë kohë në ish-Jugosllavi për krijuesin ka qenë mirë, shumë mirë e ka pasë. Pse e ka pasë mirë? Na e kena pasë pushimoren në Deçan, e kena pasë pushimoren në Batllavë, e kena pasë pushimoren në Paris, tonën e kena pasë, ka qenë dhoma jonë. Bile herën e fundit unë e pata marrë shpërblimin "Moša Piada", unë edhe Kadrushi edhe Muslim Mulliqi edhe shkum atje. Atje kena punu, kena nejt, t'gjitha i kena pasë, i kena pasë beneficinet që na kanë dhonë ata. Kështu që, neglizhenca e tyne, na i murren tjerët krejt. Ka qenë në Grozhnjan njo, në Grozhnjan e komunës Buja, a e dini ku osht? Në Istra, Istra në kufi me Italinë, dymbëdhjetë kilometra Italia. Dalishim atje në Itali i marrshim materialet. Me leternjofitim dalshim atje, kurrëfarë problemi s'ki pasë kurrë.

Kështu që, ka pasë shumë bukë. Aty kush ka dashtë me punu, aty ki pasë mundësi me përparu shumë edhe kena punu shumë kena punu atje. Kur shkojshim në Grozhnjan i marrshim punimet e veta, hapshim ekspozitë, ka qenë lokali special vetëm për ekspozitë. Për nder atje kur ardhshim me një xhep kogja të fryt, i shitshim punimet edhe kalojshim mirë. Për krijusin ka qenë mrekulli, i kanë dhonë ateleja disave, disave edhe aty jonë ditë qysh jonë shku, kush osht' ma i afërt aty, njoni-tjetrit ia kanë dhonë atelenë. Nuk i ka dhonë shumë me merita, kështu po ta thom me të drejtën, po i ka dhonë pa merita, qashtu i kanë dhonë çka t'i bojsh, po apet s'kena mbetë keq. Kështu që, në atë kohë, kultura ka qenë në kulminacion, ka punu Teatri.

Erëmirë Krasniqi: Ktu, a në Jugosllavi?

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Ktu, a në Jugosllavi si tanësi?

Hysni Krasniqi: Ktu edhe në krejt Jugosllavinë. Ktu edhe në krejt Jugosllavinë.

Erëmirë Krasniqi: Çka ndodhke ktu?

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Çka ndodhke? A mundesh me na jep ma shumë detaje çka ndodhke, a mundesh me përshkru?

Hysni Krasniqi: Po, si jo. Ka pasë koncerte, “Okarina Art” u nda s’di sa herë, ka pasë balet, ka pasë të gjitha sa i përket kulturës, sportit. Ju p’e shifni edhe vet në sport, na kurrë s’kena mujt me mbri në sport çka kena mbri tash. Pse? Si e pajke që osht’ sporti i mirë, sportist i mirë dikun në nifarë lamije të sportit ato ja zbutshin, ja zbutshin talentin. Tash? Tash, veç a je i aftë, mundesh m’u prezentu ku t’dush. Ti a po e sheh çka po bon Majlinda. Majlinda Kelmendi osht’ ambasadorja ma e fuqishmja në krejt Kosovën. Ai po na njeh Kosovën me Majlindën ma shumë se sa qita që po na udhëheqin. Ti a po e sheh që po na marrin edhe ata që na i kanë njoftë?

Erëmirë Krasniqi: E në atë kohë çka ndodhke?

Hysni Krasniqi: Në atë kohë?

Erëmirë Krasniqi: Po.

Hysni Krasniqi: Futbolli ka qenë, futbolli, futbolli ka qenë. Karate s’osht’, nuk ka qenë ku me ditë çfare. Tu na ka qenë futbolli, basketbolli, handbolli. Këto kanë qenë në kulminacion, por edhe boksi. Boksi ka qenë, ka qenë një trajner u thirrë Lah Nimani, po ka qenë i mrekullushem ai ka qenë. Mo asi trajneri s’besoj që na lindë Kosova. Ku shkojshim fitojshim, se dike me ushtru ai, ushtrojke shumë bukur. Kur e pajke që po don me hupë ardhke me pushu, me pushu aty në karrikë ia bojke disa sende veshi, ai ia gicke [kafshim] veshin *xik* {onomatope} e tranojke krejt. Tani ai (qesh), ai fitojke patjetër, qeshtu ka bo Lahi.

Erëmirë Krasniqi: A ju kujtohen kto sportet në qytet...

Hysni Krasniqi: Kena pasë, po kena pasë edhe kto vrapimet që jonë konë, vrapimet. U konë nifarë Hashim Kolovica, mjerisht që t’ish konë najfarë italian, a najfarë, ku me ditë çka ish’ bo ai. Ai ka qenë vrapusi ma i miri që ka ekzisu, ato s’ka, ai ka qenë diçka i mrekullushëm, veç natyra që e ka lindë ashtu.

Erëmirë Krasniqi: A ka fitu çmime?

Hysni Krasniqi: Po, ka fitu ai. Tash shiqo, çka ka fitu ai i varfun i shkreti. Ai me pasë konë tjetërkund ku me ditë çka kish bo i shkreti. Hashim Kolovica, prej Kolovice u konë bash. Krasniq edhe ai u konë. Ka pasë gara me bicikletë. Unë vet kom qenë biciklist, kom bo gara, mu sporti m’ka majtë kështu hala. Kom bo gara rreth e përçark Kosovës e një pjesë të Serbisë. Si kena shku ktu në Karagujevc, Nish, kemi ardhë në Prishtinë, tani kena hi knej në Prizren, në të vërtetë në Pejë, në Prizren maleve anej përpjetë edhe jena ardhë prapë në Prishtinë ktu me bicikletë.

Pjesa e Tretë

Erëmirë Krasniqi: Si u konstitunë departamentet?

Hysni Krasniqi: Bazamenti kryesor, njeri kryesor i artit figurativ, që e ka formu artin ka qenë Muslim Mulliqi. Muslim Mulliqi ka qenë një piktor i mrekullshëm. Ai ka qenë një, nën dy ka qenë Gjelosh Gjokaj. Gjelosh Gjokaj ka qenë piktor edhe grafist. Gjeloshi ka qenë një person shumë njeri i mirë, shumë demokrat edhe shumë i afërt me studenta, shumë i afërt me studenta, po ai nuk e ka ditë gjuhën se ai ka qenë prej Malit të Zi, prej Vuthaj anej. Kish jetu anej dikun ka Vojvodina kish jetu ai, se ni vlla e kish pasë pilot a s’di çka. Veç muj me ta thonë që ka qenë shumë, unë me Gjeloshin e kemi pasë veç ni gjumë që na ka nda, veç gjumi që na ka nda edhe e kom pasë profesor. Po unë kom msu prej tij shumëçka. Unë ja di për faleminderit atij njeri shumë, shumë, shumë ja di për faleminderit, për Zotin atij eshnat mos iu kalbshin. Shumë njeri i mirë ka qenë. Ai u konë në gjendje me nejt me studentin, me studiu, me punu, me bisedu për gjithëçka, Gjelosh Gjokaj. Muslimi ka qenë ai pak ma bekri ka qenë ai (qesh). Muslimi ka qenë bekri. Ai ka punu në atele të vet, kur ka ardhë i ka kontrollu studentat, ka thonë “Ditën e mirë e bofsh!” U kry hesapi, si në Akademi të Beogradit.

Qashtu ka ndodhë edhe në Beograd. Ka ndodhë me javë s’e pajshim profesorin, ama ardhke i kontrollojke punimet çka ki punu mrenda javës, bojke kritika, “Këto mirë, këto keq, këto kështu rregulloje”, po. Në Beograd e kom pasë Boško Karanović e kom pasë profesor edhe Milo Milunović u konë, ky u konë pak i vrazhdë u konë. A pedagog ky Boško Karanović u konë shumë pedagog i mirë edhe profesionalist i mirë edhe si njeri i mirë u konë. Ky ka qenë prej Krupës anej të Bosnës atje, po. Qeshtu...

Erëmirë Krasniqi: Edhe në Beograd ju keni bo grafikë krejt kohën, e jeni përcaktu?

Hysni Krasniqi: Po, krejt. Vetëm grafikën edhe pikturën e kom punu. Unë pikturën e kom kry te nifarë Mladen Srbinić. Ai u konë me prejardhje maqedone, po ka jetu në Beograd, në Beograd ka jetu. Kështu që, në përgjithësi na ktu me studenta kena organizu shumë kur kena ardhë në Akademi të Arteve. Kemi organizu ekspozita t’përbashkëta me studenta vet me qëllim që me ngrit studentin.

Erëmirë Krasniqi: Ku i majshit? Në çfarë hapësira?

Hysni Krasniqi: Nëpër klasa, nëpër klasa, nëpër korridore, në teatër, mas shumti se tash pak po m’bijnë pak, ma s’shumti kena pasë na n’teatër, në foajenë e teatrit, në foajenë e teatrit qato e kena pasë galeri na. Bile m’kujtohet ni herë, kjo ka qenë në ‘77-shin, i ndajshim shpërblimet qeshtu me kto komisionet e përbashkëta kështu edhe thanë ni herë, “Hajt te marrim ni herë ni komisionin prej s’jashtit.” “Hajt!” E murren prej Lublanës, prej Zagrebit, prej Beogradit, e murren nifarë Zoran Kržnik, kritiki ma i njohun në krejt Ballkanin edhe unë qatherë ja nisa me “Grunaja” atë ciklin e grunajave dhe i hapa unë grunaja, unë atëherë i qita. Kanë hi aty e din si kta tonët shqipëtar mo, popullin shqiptar ka me shkatrru tri sene: nepotizmi, lokalizmi edhe xhelozia. Ky Zoran Kržnik thotë, “Qiky ka me marrë shpërblimin” për grafikën e mija. Ai s’e dike kush jom unë, se nuk m’ka pa kurrë bile, ma ka pa veprën. Tash çka po bojnë kta, “Jo”, tha, “ky e ka marrë vitin e kalum”, “Çka?” Po thotë serbisht, a dini serbishten ju? “*Svake godine ima da dobije ako je dobar*” ”Për çdo vit ka me pranë nëse ky osht’ i mirë.” Edhe ia msheli aty, s’guxun me bo zo. Ai ishte kritik i mirë, kritik i fortë. Qeshtu ka qenë pasha nerën.

Unë në Slloveni kur kom hap ekspozita me 80-të grafika të vogla ka qikaq qe, kom ble Reno 4 [Renault] fine t’ri prej Sllovenisë, veç ja kom shti çelsin, me 80-të copa grafika. Kështu që, slloveni, ndëgjo, slloveni, gjermani kto e vlerësojnë punën e artistit, ktu nuk e vlerësojnë punën e artistit. S’dinë bre kta, jonë mosvet... nuk dinë kta çka osht’ arti.

Erëmirë Krasniqi: A i kishit ato sallonet në atë kohë?

Hysni Krasniqi: Çfarë sallonesh po mendon?

Erëmirë Krasniqi: Pranverore, vjeshtore...

Hysni Krasniqi: Po, ka qenë “Salloni Pranveror”, “Salloni Vjeshtor”, tani e majshim përpara edhe ni “Sallon të Vizatimit”, t’vizatimit edhe aty kena pasë shpërblime, kena pasë, krejt i kena pasë aty. E formojshim katallogin, pllakatet, shtesat, t’gjitha {kollitet}. Ku kena pasë ekspozita edhe jashtë kemi pasë ftesa, kemi pasë katalloge, kemi pasë tonat, tonat i kemi pasë, po. Kështu që, ka qenë nifarë rregulli ka qenë. Tash s’ka rregull, tash po mundohen do privat do...

Erëmirë Krasniqi: Hajt të mos t’i hijm qashtu me fol se mandej po bohem na krejt shumë t’idhnum.

Hysni Krasniqi: Veç urdhëno.

Erëmirë Krasniqi: Po mendoj ju punojshit në Akademi, a qysh i keni thonë atëherë, në Fakultet të Arteve...

Hysni Krasniqi: Po ndëgjo, deri vonë u konë Akademi...

Erëmirë Krasniqi: Edhe në ndërkohë ishit tu kriju gjenerata të reja të artistëve. A u bo jeta kulturore ma dinamike masi kjo skena e artit...

Hysni Krasniqi: E vërtetë osht’.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ndodhke jeta n’qat kohë kur tash mo veç e kishit Universitetin në Kosovë, nuk kish veç prurje prej Beogradit, Zagrebit...

Hysni Krasniqi: E vërtetë osht’, e vërtetë.

Erëmirë Krasniqi: A ish t’u ndodhë diçka lokalisht? Qysh ish situata atëherë?

Hysni Krasniqi: Përpara kena pasë edhe Shoqatë... s’kena pasë Shoqatë të Artistëve Figurativë përpara hiç, po “Shoqata e Artistëve Figurativë” ka qenë e Serbisë, Beogradit, e Serbisë. U ndam na, m’kujtohet si sot kur jena nda, unë, Engjëlli [Berisha], ky qysh e pat emrin, Anton...

Erëmirë Krasniqi: Gllasniqi a?

Hysni Krasniqi: Anton Gllasniqi bravo, Anton Gllasniqi, shumë bukur. Anton Gllasniqi edhe kena qenë në atë mbledhje edhe u ndam na prej tyne krejt. Na dojmë, tham, “Na jemi autonomi, dojmë me pasë shoqatën tonë, dojmë me pasë galerinë tonë, dojmë me krejt”. Prej atëhersh na ja kena fillu krejt mbarë kena shku. Kena fitu galerinë, kena fitu shoqatën, kryetarin e shoqatës, krejt. Galerinë e fitum në “Boro Ramiz”, po në Pallatin e Rinisë, aty se neve na ka metë kjo hala (qesh) “Boro Ramiz”. Në Pallatin e Rinisë u formu Galeria, tani hajt hajt hajt ja fillun prej atyhit u ankojshin atje, çka po di unë, lloj tregtie u konë, na murrën tani ato e çelën ktu në këtë pjesën Galerinë ku osht’ sot.

Erëmirë Krasniqi: Ajo ndodh henez në ‘95-tën.

Hysni Krasniqi: Po, qashtu në ‘95-tën. Shiqo me data s’muaj m’i ditë, veç e di qysh kanë shku.

Erëmirë Krasniqi: Po du me thonë ndodhë me ni periudhë ku na mo s’kemi qasje hiç në Galeri.

Hysni Krasniqi: Ja, mo qasje mo me to s’kemi.

Erëmirë Krasniqi: Po çka ndodhë para? Domethonë ju keni qenë pjesë edhe e...

Hysni Krasniqi: E kujt?

Erëmirë Krasniqi: E ekspozitës të parë kur u hapë Galeria. A ju kujtohet qysh ju kanë qasë, qysh ja u kanë marrë punët...

Hysni Krasniqi: Shiqo, Galeria kur u hapë ma s’pari ka qenë me të thonë të drejtën masovike ka qenë, simpozante ka qenë, e mrekullushme ka qenë krejt. Krejt krijtë kena ardhë aty, kena marrë pjesë në hapje, t’gjithë, ardhshin gazetarët, ardhshin me kamera kanë inçizu, kanë bisedu. T’gjitha ato kanë ardhë për mrekulli të Zotit po, krejt kritikët kanë ardhë të artit çka ka pasë aty. Kështu që, prej atëherëshit ishte nifarë rregulli, kur hapshe, kur dojshe me hapë ekspozitë u dufke m’u prezentu niherë, m’i pa punimet komisioni, t’ardhke komisioni në atele, e pajke çka po punon ti, çka ki punu, qito sene. Qashtu atëherë i kanë thonë, “Ti ki mundësi me ardhë me këtë datë” ose e caktojke datën ose krijusi ose vetë Galeria, se shpeshherë u mbushke reni nuk kishe mundësi me ja plotësu dëshirën t’gjithëve përnihërë. Qeshtu ka qenë.

Erëmirë Kasniqi: E...

Hysni Krasniqi: Çdo krijus, m’fal, qe ka ekspozu ka pasë beneficione, ka pasë. Prej 50-ve deri në njëqind euro, marka, dinarë. Veç ka qenë faktikisht i pagum, kugjo mos me bo me ta pagujt bile materialin që e ki harxhu, ngjyrën, letrën, këto vajin, këto t’gjitha shkojnë mudi. Bile materialin me pagu kurgjo mos t’pastë tjetër, se kohën s’mund me pagu kërkush, kohën e krijusit, se ni krijus mundet me punu ni grafikë me javë e me muaj e, po deri sa ai e kryen. Kështu që, osht’ e mundshme edhe piktura edhe grafika edhe skulptura, t’gjitha jonë, po.

Erëmirë Krasniqi: Shoqatat a organizojshin...

Hysni Krasniqi: Po shoqata i organizojke ato.

Erëmirë Krasniqi: Edhe brenda edhe jashtë vendit.

Hysni Krasniqi: Shoqata po, mrenda edhe jashtë. Na kena pasë disa herë në Gjermani, Metalip Qosaj u konë si përfaqësues në Ambasadën e Kosovës. Ai na thojke qikaq vepra artistike, qikak artistë. Na i përgatitshim, na s'do me thonë me shku tonë, na i çojshim veprat, por na u kthejshin prapë na u kthejshin, atyne që ju shitke ja u kthejshin t'hollat, po. Veç e hapke xhirollogarinë, numrin e xhirollogarisë edhe aty i marrshim. Po thom, ka qenë shumë e kordinume mirë shoqata.

Erëmirë Krasniqi: A ka qenë e lidhun me shoqata të tjera të Jugosllavisë?

Hysni Krasniqi: Po, po, kem qenë edhe ka qenë edhe ndërkombëtare bile edhe ndërkombëtare ka pasë. Tani dikur fillum m'u lidhë edhe me shoqatën e Shqipërisë, bile e kom librezën qaty.

Erëmirë Krasniqi: A keni qenë ju në këto shkëmbimet me Shqipërinë në të '70-tat?

Hysni Krasniqi: Po, unë kom qenë në Shqipëri ma s'pari në '73-shin, në '73-shin si profesor i gjimnazit, se unë kom fillu prej të '70-ës me punu në gjimnaz, se '70-të anej kom qenë si ushtar, jom kthy e meniherë m'kanë pranë në gjimnaz. Kur kena shku në Shqipëri, na kanë pritë për mrekulli të Zotit, s'ka qysh ma mirë.

Erëmirë Krasniqi: E pse juve të shkollës së mesme profesorat? Çfarë bashkëpunimi ka qenë?

Hysni Krasniqi: Ka pasë bashkëpunim atëherë. Ja fillun bashkëpunimet me galeri e në përgjithësi me kulturë edhe arsim. Se atëherë ja fillun ata me çu pedagogë tek ne edhe në Akademi edhe nëpër Universitete të Prishtinës, këtu në Filozofik, e në Gjuhë Shqipe e kto krejt ja fillun me çu. Unë kom pasë shkue, krejt grupi i profesorëve kena shkue në Shqipni. Aty na kanë pranë shumë mirë, kemi nejt jena knaq. Shkojshim i pajshim fabrikat, shkojshim në Universitetin e tyne, me shiqu çfarë Universiteti osht' aty, shkollat e mesme të tyne. Aty kishte punë, punë të madhe kishe.

Erëmirë Krasniqi: A ju kujtohet qysh u dokë Shqipëria atëherë?

Hysni Krasniqi: Atëherë (qesh) osht' keq me t'thonë. Në atë fillim unë e kom pasë një vlla, na tonë e kena dashtë Shqipërinë, po duhet nifarë mase. Kur e kom pa ni herë ni aksion fmi, fmi me thonë 15, 16 vjet s'ka pasë ma shumë, me ato shamiat e kuqe, me buzët krejt shkrum, t'u punu nëpër ara edhe nëpër rrugë në binara të trenit. Kur i kom pa gratë tu e shty basa, gratë basa ty shty nëpër ara.

Erëmirë Krasniqi: Tu shtyp çka?

Hysni Krasniqi: Tu shtyp basat, a e din çka jonë të arave ato grumbullat, ato i kom pa. Te na, te na gratë s'i qesin në ara me punu te na, nuk i qesin shumë, atje krejt. Burrat veç po rrishin nëpër kafe, gratë po punojshin.

Erëmirë Krasniqi: E qyteti, qysh u duke qyteti në atë kohë?

Hysni Krasniqi: Qyteti ka qenë i pastër. Na kena jetu në “Hotelin Dajti”²⁰, para “Hotel Dajti” ka qenë ky Stalini²¹, busta e Stalinit, po po busta e Stalinit, po ma tutje u konë edhe busta e Skëndërbeut, po. Pastërta në kulminacion, po ndërtime shumë kasolla t’vogla përreth Tiranës. Kështu, Tirana rrugët e gjana, t’mira t’pastra krejt, aty s’kishe me pa kund makinë.

Erëmirë Krasniqi: A ju përcjellke najkush?

Hysni Krasniqi: Po, po, si jo. Të organeve të brendshme na përcjellshin. Bicikleta, krejt bicikleta, autobusa t’vjetër që i çojshin nëpër uzhina, nëpër fabrika aty e pajsha. Njerëzit i pajshim krejt në një esembe, jo krejt në ni esembe po ni ngjyrë t’kaltërt të veshun, kështu krejt komplet. Nuk pajshe diçka kështu, rrallë dikund në mbramje dalshim i pajshim kto. Por, na... e vrejsha neve qysh na kqyrshin. Na t’veshun shumë mirë, m’erdhke edhe keq me thonë të drejtën. Po ça t’i bojsh, Shqipnia qysh u konë e çka osht’, qysh ka qenë Shqipnia, ai që u konë përpara e ai që shkon qitash Paris osht’ qitash, qaq ka përparu Prishtina... kjo Shqipnia, Tirana e Shkodra e krejt, Durrësi e ka përparu me t’madhe. Ju nuk mundeni me marrë, nuk mundesh, s’ta rrokë logjika veç Durrësi çka u zhvillu përgjatë bregdetit, kjo është e pabesueshme.

Erëmirë Krasniqi: Sa qëndrut atje në atë kohë?

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Sa keni qëndru?

Hysni Krasniqi: Si?

Erëmirë Krasniqi: Në të ‘70-tat sa keni qëndru?

Hysni Krasniqi: Në ‘70-tat se unë, veç ndëgjo, se na 2007-shin e kena ble ni banesë. Qaty ku e kena ble na kund ni ndërtesë s’ka pasë, krejt n’plepa jonë konë. A e din çka jonë plepat? Plepa, pisha krejt komplet, thojkë s’ka guxu kush prej regjimit ni gjethe me nukë aty. Kund plep nuk sheh mo, krejt e kanë bo ndërtesa, ndërtesa sa t’dush, sa t’dush. Qeshtu osht’ puna e Shqipërisë.

Erëmirë Krasniqi: Po atëherë sa ditë nejtet?...

Hysni Krasniqi: Atëherë kena nejt njo ni javë ditë a dy qashtu, ni javë ditë m’doket kena nejt qashtu. Ni javë ditë kemi nejt edhe jena kthy. Veç na kanë pritë mirë. Na kanë çu në fabrikën ku bojnë kto lugë e

²⁰ Hotel Dajti ishte një hotel në qendër të Tiranës, Shqipëri. Mbante emrin e Malit të Dajtit aty pranë, ishte qendra kryesore për vizitorë dhe diplomatë ndërkombëtarë gjatë periudhës socialiste të Shqipërisë, është blerë nga Banka e Shqipërisë dhe aktualisht nuk funksionon si hotel.

²¹ Joseph Vissarionovich Stalin (1878-1953), drejtoi Bashkimin Sovjetik nga mesi i viteve 1920 deri në 1953 si sekretar i përgjithshëm i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe kryeministër i Bashkimit Sovjetik.

ombrella e qito farë sene kanë pasë aty, s'kanë pasë aty. Lugët i bojshin me... çka ki me bo, qaq ka pasë mundësi ai. E ka pasë ni t'mirë Enveri që ni cent borxh s'i ka lonë, a e din ti kto? I ka pasë armiqtë përreth, e ka pasë Greqinë, e ka pasë Italinë, e ka pasë Sërbinë. Thojnë, "Pse gjithë ata bunkera?" Po s'ka pasë qare pa i bo ato bunkera ai për me mbrojtë shtetin, s'ka aty.

Erëmirë Krasniqi: A ke imazh çfare e kishit prit ju për Shqipërinë?

Hysni Krasniqi: Si?

Erëmirë Krasniqi: A ke, a u duke Shqipnia qashtu qysh e kishut prit që ka me qenë? A ma keq, a ma mirë?

Hysni Krasniqi: Ja (qesh) s'e kena prit na qashtu me të thonë të drejtën, po s'e kena prit na qashtu. Bile, ni vlla osht' keq me thonë, tha "Qysh ish' Shqipnia bre vlla?" "A po don me të tregu t'drejtë, a me t'rrejt?" "Jo," tha, "tregom t'drejtë", i thashë qeshtu qeshtu, tha "A valla ti je shpiun i Beogradit" (qesh). I thashë, "Valla, po gabon shumë, veç kqyre" i thashë "ti me mrrri se ti hala je gjallë hala" i thashë "do të shkojsh ti vet m'u bind". Shkoj e u kthy, "Qysh ish?" "Ai vlla le." (qesh) Eh, i thashë, "Çka t'kom thonë unë, a të tregova, thash a po don me të tregu t'drejtë a me t'rrejt". "Jo," tha, "të drejtë tregom", e të drejtën po tregoj valla. (qesh) E qeshtu u konë Prishtina, Shqipënia. Vetëm që me ta thonë të drejtën, Shqipëria i ka të gjitha resurset me përparu shumë, m'u bo ma mirë se Zvicrra. Pse? E ka detin, sa kilometra det ka bre ju nuk e dini sa, çfarë deti të pastër ka, e ka malin, i ka xehet, i ka rrugët, me pa çfarë rrugësh. O Zot ka përparu shumë, shumë ka përparu. Vetëm që njerëzia, hala ka nevojë m'u civilizu ata njerëz, ata njerëz duhet m'u civilizu si qitu.

Erëmirë Krasniqi: (qesh) Po kthehem te...

Hysni Krasniqi: A pe sheh? E qeshtu... në Shoqatë na kemi pasë shoqatat, kena pasë pothuajse ka qenë i privilegjum krijusi, krijusi ka qenë i privilegjum në atë kohë, në atë kohë po mendoj, para lufte. Tash aspak nuk osht' i privilegjum.

Erëmirë Krasniqi: A po m'tregon pra për qito privilegje që i keni pasë para '99-tës? Qysh ka qenë qajo jeta për krijusin?

Hysni Krasniqi: Po, krijusi ka pasë të drejtë në galeri me hapë ekspozitë, me ja përgatitë katalogun, me ja përgatitë ftesen, me ja përgatitë pllakatin edhe në fund Komuna ja ka ble njo ose dy, Galeria e ka majtë në fond [kolekcion] njo ose dy, Ministria e Kulturës gjithashtu. Kështu që, krijusi ka pasë, për qato ka qenë, qaj osht' privilegji. Privilegj kemi pasë ne që kemi shku në shoqata pa asni cent. Ke pasë me hangër, me pi, me fjetë edhe plus ke pasë material me punu per to, me punu ndaq në vizatim, ndaq në pikturë, ndaq skulpturë, çka t'dush, po qito privilegje ka pasë. Ke pasë mundësi me shku ku t'dush ti, veç e ke pasë pasaporten jugosllave, pos në Amerikë s'ki mujt, çdo shtet ki mujt me shku.

Erëmirë Krasniqi: A shkojshit ju? A shetitishit...

Hysni Krasniqi: Jo, unë kom shku pos në Francë kom shku, në Francë kom shku...

Erëmirë Krasniqi: Për shkak të vllaut, a qysh?

Hysni Krasniqi: Pom edhe për shkak të vllaznive, kisha qef m'i pa vllaznitë, me nejt me ta edhe shkaku i materialit. Se unë grafikën nuk e shtyp në letër sikurse disa që i shtypin në hamer. Çka osht' ajo në hamer, 20 cent. Unë në ash, në ash osht' shumë i shtrejtë. Ngjyrat i marr *La grang*, ose *Fabriano*, në këto i shtypi. Kështu që, kur te shtypi unë grafikën ai osht' taman vepër artistike, jo pallavra. Qashtu osht' puna, se si ta rrok dielli ni herë e merr ni ngjyrë tjetër, po.

Erëmirë Krasniqi: A mundemi m'u kthy veç edhe pak te qajo qysh kanë, kur u bo qajo ekspozita e parë se po më intereson pak ma shumë n'këtë rast.

Hysni Krasniqi: Po.

Erëmirë Krasniqi: Ju i keni do punë aty të ekspozume. Qysh ka ardh...

Hysni Krasniqi: Në Galeri aty?

Erëmirë Krasniqi: Jo, ekspozita e parë që është bo najherë në "Boro Ramiz" në Galeri.

Hysni Krasniqi: Po, po...

Erëmirë Krasniqi: Jonë edhe do punë t'juja të ekspozume. A ju kujtohet qysh kanë komuniku me juve? Qysh ja u kanë komuniku lajmin që po hapet?

Hysni Krasniqi: Lajmi, hapet ksi soji, për shembull ti ki dëshirën me hapë ekspozitën në Galerinë e Arteve në Prishtinë, atëherë kur ka qenë në Pallatin e Rinisë.

Erëmirë Krasniqi: S'po më kuptoni. Kur u hapë Galeria për herën e parë...

Hysni Krasniqi: Po.

Erëmirë Krasniqi: Ekspozita e parë najherë edhe nuk ka pasë ekspozita individuale, po ka qenë një ekspozitë kolektive edhe ju kanë ftu në qato se ju keni punë aty.

Hysni Krasniqi: Po qashtu.

Erëmirë Krasniqi: A ju kujtohet qysh ka qenë? A mundesh me ma kallxu qat lajmin e parë që po hapet Galeria?

Hysni Krasniqi: Lajmi i parë, para se m'u hapë Galeria?

Erëmirë Krasniqi: Ëhë.

Hysni Krasniqi: Para se m'u hapë Galeria ma s'pari, ose me konkurs ose me telefon në mënyrë individuale na lajmrojnë çikaq punime me pru edhe e kallxun datën kur është vepra e punune, ni vit ose dy ma shumë jo e vjetër edhe konkuron me qato i dorëzon atje. E merr komisioni edhe vjen komisioni, tjetër komision e kontrollon edhe hapet ekspozita, i qesin nëpër...

Erëmirë Krasniqi: A po ju kujtohet juve ekspozita e parë në Galeri?

Hysni Krasniqi: Po qysh jo, si sot po m'doket p'e shoh.

Erëmirë Krasniqi: Sa vepra i keni pasë aty?

Hysni Krasniqi: Po shiqo...

Erëmirë Krasniqi: Njo, dy?

Hysni Krasniqi: Jo more, në kolektive a? A individuale?

Erëmirë Krasniqi: A po ju kujtohet dita kur u hapë Galeria?

Hysni Krasniqi: Dy, tri. Nuk m'kujtohet bash dita, po e di qysh osht' hapë aty. Aty vijinë...

Erëmirë Krasniqi: Osht' hapë me një ekspozitë.

Hysni Krasniqi: Po, po me një ekspozitë. Aty i çojnë ftesat, ftesat i kemi ose me t'shtypit t'lajmron, na shtypin gjithë, s'ka pasë ku me ditë me thonë, tash që ka gazeta shumë, ka qenë "Rilindja"²², "Rilindja" ka qenë edhe kurgjo. Në "Rilindje" e dishe kur hapen, në sa ora, krejt edhe shkojshim gjithë komplet. Drejtori i Galerisë e hapë ma s'pari ftesën...

Erëmirë Krasniqi: A po ju kujtohet fjalimi i Pajazit Nushit pra kur u hapë Galeria?

Hysni Krasniqi: A s'më kujtohet valla. Pajazit Nushi ka qenë profesor shumë i mirë, një pedagog i mrekullushëm, shumë pedagog i mirë me tona t'mirat, njeri ma t'mirë nuk ka pasë se ai, hiç, se unë kom punu me to në gjimnaz. Ai në gjimnaz ka dhonë msim, Pajazit Nushi. Nuk m'kujtohet po ta thom të drejtën se osht' moti osht' kjo shumë edhe unë kom pasë trauma kom pasë unë gjatë qisaj lufte.

Po du me thonë që, ajo ekspozitë kur osht' hapë për herë të parë ka qenë shumë manifestive, ka qenë me pjesë të muzikës me flauta, me recitime, me tonat i kanë pasë aty. Po, po, jonë organizu ato, {kollitet} jonë organizu ato. Tash, rrallë tash p'e praktikojnë, se përpara ja naj flautë, ja naj piano, ja naj recitim, nuk osht' hapë asni ekspozitë. Tash po hapet ekspozita po edhe ma mirë, sa ma thjeshtë qaq ma mirë del. Se shiqo, ai nuk po hapë koncert aty, por po hapë vepra artistike, vepra le të flet, jo ti. Unë

²² Gazeta Rilindja është publikuar për herë të parë më 1945 dhe është gazeta e parë në gjuhën shqipe në ish-Jugosllavi. Me 5 shtator 1990, nga pushtetit serb ndalua botimi i saj.

kom qenë në Paris, në hapjen e një piktori shumë të njohun Francis Bacon²³. A keni ndëgju për to? Kur është hapë e kom pa një tavolinë nja dhjetë metra të gjatë në midis me një çarshaf t'bardhë, disa pije. Kush një fjalë folë s'e ka, pos i kanë shiqu veprat. E kom prospektin, katalogun e tij, që me dorën e tij ma ka nënshkru mu. Ma ka dhonë katalogun, qaj person, se i tha njoni që ky osht' prej filanit venit, po ka qef edhe ma dha. Pos ktu tu na a po e sheh çka po bohet e mërztishme ajo, po majnë ligjerata. Po çka po manë ligjerata aty? Punimi osht' aty, punimi flet vet, jo tash ti me bo aty, me... shiqo njerëzit edhe po mërztiten aty t'u nejt n'komë aty edhe shpesh herë i kom vrejt dalin, dalin prej ekspozitës, dalin. A e ki vrejt?

Erëmirë Krasniqi: Ëhë.

Hysni Krasniqi: Po s'ki çka flet ti, ti ki ardhë me pa ekspozitën. Ekspozitën secili e sheh qysh e ndin ai vet, qysh e ndin ai vet, ajo osht' ekspozitë. Te na po kanë ka pak qef, çka po di unë, reklamë vetit po i jepin.

Pjesa e Katërt

Erëmirë Krasniqi: A ju kujtohet '89-ta ose të '90-tat kur ju kanë qit prej punës?

Hysni Krasniqi: Po, shumë mirë m'kujtohet.

Erëmirë Krasniqi: A mundesh me na kallxu qysh ka ndodhë?

Hysni Krasniqi: Mu m'kanë qit prej pune me datën 13, 1989, qashtu diçka e kom të shënume, krejt i kom. Kur m'kanë qit unë nuk kom dasht' pse punë, "Pse me dal, ti nuk m'ki pranu" thojsha, "mu nuk m'ki pranu ti, dihet kush m'ka pranu, jo ti". Unë edhe Kadrush Rama kemi nejt aty edhe mu ma kanë prunë pastruse, pastruse ka qenë ajo, veç ndëgjo, pastruse. Ajo ka qenë pastruse që i ka pastru dhomat e profesorëve, të nxansave, studentave edhe tha "Profesor me ma nënshkru qitu", thash "Çka me nënshkru?" edhe po i thom serbisht, thashë "*Idi uzmi metlu i čisti*" Merre fshisën me pastru aty, largohu prej ktuhit. Edhe hiç shkoi ajo. Unë po vi prapë aty në msim në klasë, në sallën e profesorave e ashtu kur vjen njo e ka bajtë postën ni shqipëtar "Profesor," "Urno?" Tha, "duhet me nënshkru", i thashë "Çka me nënshkru?" Thashë, "Hajt bre shko ti baj posta, lej ti kto se s'osht' kjo për ty o zotri, jo. S'e nënshkruj."

Hajt tash qashtu vjen njo tjetër, bash ish student i imi, skulptorë, nifarë Zoran Karalejić, skulptorë. Unë i thojsha Kërle, cung i thojsha atij. Tha, "*Profesore treba da potpišete*" [Profesor, duheni me nënshkru] Thashë, "Kurrësesi nuk vjen në konsiderim unë me nënshkru ktu, hiç. A e kem të kjartë? Ma s'pari s'po e marrë vesh çka osht' kjo." "S'po e merr vesh a?" "Po". Shkojnë e marrin nifarë ish-sekretar tonin,

²³ Francis Bacon (1909-1992) ishte një piktor figurativ britanik me origjinë nga Irlanda i njohur për imazhet e tij të emocionalisht të papërpunuara.

nifarë Ballata u konë, nifarë mosvet. E shkrujnë shqip, ma përkthjenë shqip. Eh, thashë, “Lumi ti more Ballatë qe ku, në çfarë gjendje ke ardhë ti. Për pesë grosh po shitesh. S’e nënshkruj!” Thashë, “A e din ti, a po m’njeh ti mu hiç, a jo? S’e kom nijet me nënshkru”. Jom shku n’shpi, jom ardhë prapë me Kadrushin aty, kur kanë ardhë policia, pesë-gjashtë vetë me automata na kanë qitë. Dulëm, çka me bo, durë thatë na dulëm, s’e nënshkrova. Ma kanë pru në banesë, në banesë ma kanë pru, pa nënshkrim e kom, qashtu ma kanë pru vendimin. Qeshtu ka qenë zojë, për ndër po.

Erëmirë Krasniqi: Qysh kanë qenë fillimet e Fakultetit të Arteve po m’intereson nëse mundesh pak ma...

Hysni Krasniqi: Atëherë Fakulteti u organizu, kena pasë rektor Ejup Statovcin, i vetmi në Universitet, Fakulteti jonë, i vetmi në Universitet që ka punue me Republikën e Kosovës, me rregullën e Republikës së Kosovës. Enver Statovci, ky...

Erëmirë Krasniqi: Ejup.

Hysni Krasniqi: Ejup Statovci, Ejup Statovci tha që duhet gjithëqysh na me bo zgjedhje. Bonëm zgjedhje secili nëpër atele të e veta. Unë e kom pasë atelenë në banesë, ngjitë u konë, nifarë qoshi e pata bo si atele. Aty kom punue, aty i kena marrë studentat. Me krejt arsenalin tim që e kom pasë, me presë, me letër, me ngjyrë, me vaj, me nxemje, me dritë, me krejt kanë qenë te unë, kush ni cent dhonë s’ma ka, as s’e kom lyp. Aty kom punu katër vjet, katër vite t’plota jonë konë. I kom tri mirënjohje, njonën s’ma dha ni sekretar, ka qenë nifarë arrogant po nuk o problem. Kur ardhshin studentat, unë, ma s’pari kur kanë ardhë, kom bisedu me ta, “Mos ejani shumë, ejani sa ma pak, jo grup kështu, po me ardhë ka njo ka njo edhe mos ju tregoni ku po shkoni. Po shkojm te vllau dy deri n’tre”, qashtu kanë ardhë.

Ka qenë korridori i madh të unë kogja, e kom pasë maru ni bankë të madhe. Qata që vijnë ma heret pak, që mos me nirth, ka qenë nxet aty mirë, aty jonë ulë kanë nejt. Kur jonë bo bashkë krejt e kom çelë derën, jonë hi mrena, kanë punu si në Akademi, vetëm që s’u konë Akademi. Aty kanë punu, krejt ja kom dhonë, me materiale, kom pasë literaturë, m’vjen keq me thonë ama edhe literaturë m’kanë marrë studentat (qesh). Ata s’kanë marrë diçka tjetër, literaturën se kanë pasë qef, po nejse. Kështu që, aty kom punu tonë kohën kena punu. Dy herë kom punu domethonë mrena ditën, paradite edhe masdite. Pse? Se shumë grupe, nuk i zike, u duhke me nda. Bile Ibrahim Kadriu, gazetarë, shkrimtarë ka pasë ardhë ni herë edhe e patë shkru ni artikull shumë të mirë, e kom qaty t’shënume krejt. Qashtu ka qenë.

Kom pasë edhe probleme kaniherë, studenta ka tylifare. Ni herë ni student prej Gilanit, nifarë kom harru edhe emrin qysh e pat. Taman, unë veç po hi, i lash studentat shumë mirë t’u punu, kur unë hina veç ni kafe tha shoqja po ta qes, “Le”, i thashë, “çfarë kafe, tash jom t’u punu”, veç hina kur po e nij ni zhurmë. “Hysni bre”, tha, “qesi zhurme s’kom ni kurrë”, shoqja. Unë meniherë dola, kur po e shoh ni student ja kish ngjit ni femnes qeshtu {vendos dorën tek qafa dhe e largon}, dojke me plas. Fuad, Fuad Islami e ka pasë emrin, qitash po m’bjen në mend, Fuad. “Fuad?” Meniherë e ka ndërpre, a vajza e ka

pasë emrin Teuta. Po thom, “Pse bre Teutë po bon kështu?” Tha, “E Profesor, qeshtu”, ani mirë e lash niherë. Kur u krym krejt i thashë Teutës me nejt ti ktu edhe ni mashkull edhe ni femër tjetër thashë m’u ulë ktu, “Me më tregu tash të drejt” thashë, “çka ka qenë?” Tha, “Valla shok profesor”, tha “unë ja hina shuplakë”. Thashë, “E pse ja hine shuplakë studentit ti, çka...” ku me ditë çka ka pasë aty, “Po nuk osht’ dashtë ti me ja hi shuplakë”. Tani ky ja ka hi për fyti. Qat problem e kom pasë, kurrë mo problem s’kom pasë me ta.

Tani thashë, “Shiqo, a e din që unë kom të drejtë mos me t’ligjëru mo mrena unë ktu hiç”. Ja nisi po kanë “Profesor”, tha “nuk boj mo”. Thashë, “T’kesh kujdes si sillesh mo, ti a po e sheh” thashë, “çfarë problemesh kemi na. Na i kemi dy rreziqe, rrezikun prej armikut, rrezikun, ku e di unë a je smut a çka je ti, ku e di unë. Ktu e kom familjen”. Qeshtu ka qenë. Katër vite kom punu qaty. Pasha nerën krejt punimet i kom, krejt punimet që i kanë punue, krejt i kom. Kurdo do të hapi ni ditë një ekspozitë me krejt punimet edhe nëse e formojnë Akademia e Arteve kabinetin e Grafikës unë ja u kthej, nëse jo kom m’i çu në muze krejt. Jo me ja lonë atyne aty, ata i marrin i shesin, çka s’bojnë aty, i shesin, i jepin njerëzve qeshtu.

Erëmirë Krasniqi: E pse katër vjet kur kriza ka zgjatë nontë, nontë vjet.

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Pse veç katër vjet?

Hysni Krasniqi: E qe për çka, mirë e ki, plotësisht ki të drejtë ti. Atëherë shkum na si, në atë, a e din ku osht’ ti *Gradić* [Qyteza] Pejton? Aty ka qenë një hapësirë e muzikës, aty tani kena majtun ligjeratat aty. Aty shumicën ligjeratat i kena majtë aty, tani kadal kadal erdhëm ku ka qenë meniherë ushtria aty, kta UÇK-ja, aty kena punu, ka qenë në një kohë t’gjatë. Tani erdhën kta na qitën prej atyhit, tani u formum prapë erdhëm në venat tona, se veç u shlirum na.

Erëmirë Krasniqi: Qysh erdh deri te lufta? Qysh e përjetoi familja ju?

Hysni Krasniqi: A familja jonë shumë keq. Familja jonë e ka përjetu shumë keq. Pse ma s’pari? Pikë s’pari vllaun ma kanë ekzekutu në rrugën e Kolovicës me gjithë ni kushëri. Katër vetë, pesë jonë konë, t’katërt i kanë ekzekutu, njo kish qenë sigurisht djali i ri a ku me ditë, ka kcy murit edhe ka ikë. Qashtu ka qenë edhe e përjetum shumë keq.

Erëmirë Krasniqi: Ju ishit në Prishtinë n’shpi, apo...

Hysni Krasniqi: Na ishim, na ishim në banesë. Na nuk guxojsim me dalë kërkund hiç. Jo, atëherë jo, se na jena dalë prej Prishtinës qashtu mos gabofshim në prill jena dalë, në prill, në mujin prill, në mujin prill. A mu m’kanë rre me gjithë ni shok me 26-tin mars, me të 26-tin mars para, para Gjyqit të Qarkut, në anën e kundërt ka qenë një tenk, ka pasë aty t’gjithë të veshun, ka pasë ushtarë e civil e do plot çka s’ka pasë, t’përzimë. Aty neve na kanë kontrollue çka kem, “Çka kom me pasë?” Thashë. Unë

çka kom me pasë. Unë i kisha njëqind, 50 dinarë atëherë, dinarë kom pasë, a ky shoku jem i kish pasë 120 mark. Atij ia murr, atij i tha “S’ki të drejt ti me majtë marka”, a krejt majshim marka atëherë, tonë.

Atij ia murrën, ky i tha, “Kthemi more paret! Pse po m’i merr paret?” A në xhep i ka pasë, se shiqo ai osht’ dizajner i fortë bile, Osman Cakiqi thirret, ika pasë edhe amblemat e UÇK-së në xhep që i ka punu. E ka pasë shtypshkronjën e vet private. Shyqyr Zotit neve s’na hallakatën. Mu m’tha, “Qite kto”, ma pa vizitkartën profesor në Fakultetin e Arteve, tha “A ti profesor je a?” Thashë, “Po, profesor. Pse?” Unë kom dhonë edhe në dy-gjuhësi, shqip edhe serbisht. “Ah, qitash të ndreqim na. Ti” tha “je ai që je kundër këtij shteti.” Thashë, “Jo valla, ti po bon gabim shumë”.

Te murrën ato e rreh, e rreh, ja thynë dhomtë, ja thynë dy brinj, ja thynë, po. Mu m’rrehën mo deri sa u lodhën. Dojshin me ma thy qit dorë {prek krahun e majtë}, i kom shenjat hala ktu i sheh fotografitë. Ma thyn, ktu kamën dojshin me ma thy, i kom shenjat ktu krejt edhe kto fotografi jonë fotografu mas dymbëdhjetë dite, se s’kishim qasje kërkund na me dalë, mrena ishim qaty. Qashtu jena shku, diqysh jom ardhë deri n’banesë. Bash në hymje t’banesës kanë qëllu dy kojshi të hymjes, m’kanë pa, s’mujsha me hecë, m’kanë kap për krahi, m’kanë shti në ashensor e m’kanë çu në banes.

Qaty e kom pa që jom shumë keq. Trupi jem ka qenë zi, kaltërt edhe kuq, krejt trupi. Kanë marrë kryp edhe kepë edhe kanë ngri edhe m’kanë pshtjellë, kom nejt s’di sa ditë. Ajo që m’ka marrë, mos gabofsha e ka pasë emrin Mybera edhe Magribe, Magribe. Ajo s’e ka pasë burrin aty hiç gjynahit, ajo e ka pasë në Gjermani. Ato m’kanë marrë m’kanë çu aty, m’pshtillën me llastik, me qato kepë. Pi thom shoqës mas disa dite, thashë, “Po m’vjen era.” Thashë, “S’muj me duru mo kështu”. I kom hjek, i kom pastru. Qashtu kena nejt njo s’di sa ditë. Mas dy, tri dite a katër ka ardhë nifarë Dragani, ni Dragan shef i Policisë.

Erëmirë Krasniqi: Kojshi a veç...

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: A e kishit kojshi, a veq erdh?

Hysni Krasniqi: Kojshi, kojshi, kojshi i kishim. Tha, “Mrena, në ora gjashtë në mëngjes najnjo s’du me pa ktu”. Çka me bo, u mbledhëm krejt hymja, u përgatitëm edhe dulëm {kollitet}. Shkum të ky stacioni i treni, ju e dini ku osht’ ky i vogli i Prishtinës. Aty kena hyp, kena hyp n’tren, shoqja m’ka kap knej, djali knej, se veç ni djal e kom pasë ktu me veti, dy i kom pasë në Londër. Gjashtë vjet s’e kom pa njonin hiç, po.

Atëherë kem shku, him në tren na, plot ishin më t’meta fizike, me kolicë në tren. Kur kena hi n’tren erdh, kta si kontrollorë çka p’e di unë, që e kontrollojnë trenin. “Çka keni ktu?” Thashë, “Çka kom me pasë?” M’i kontrollunë, i kisha pasë unë njëqind dinarë, 50 m’i murr, 50 m’i la, qe. Kur kena zbrit prej trenit në dy antë kena pasë mina, mina nëpër tren me hecë na nëpër binarë të trenit. Kom dalë aty, shkum në Bllacë. Në Bllacë lloq, shi, ishte ai lumi kalojke aty. Çka me bo? Po i thom djalit, “Ti je, bir ti je

tash pak si ma mirë, merre naj kranë sa ma t'gjata". E murrëm bashkë me gjithë vlla, e bonëm si ktyne herë që i kanë bo kolibat, e mbyllëm me najllona qaty nëpër mbeturina e mlum sa mos me na rrok shiu.

Hinëm aty, kur po e shoh do dajë t'mi, dajtë i kom prej Gllavnikut, ishin konë aty. "Çka ki Hysni?" I thashë, qeshtu, qeshtu. Më murrëm m'çunë në ni ekipë franqeze mjekë. Ata mu m'kanë kontrollu prej maje t'kres deri n'maje t'gishtit, m'i kanë dhonë do barna çkado diçka. Na kena nejt ni ditë edhe ni natë qaty. Në ata ditën ka ardhë Fatmir Sejdiu. Kur m'ka pa tha, "A edhe ti Hysni?" Thashë, "Po valla, barëm me ty qitu". "Hajt mos ki gajle," tha, "qitash bohet mirë".

Kur mas ni kohe erdh ni komision prej Gjeneve, e panë çfarë jete kemi aty na. Kanë ardhë autobusat prej Shkupit edhe na kanë shti qashtu sikur se gjanë a beson në Zotin, dritaret e mbyllta, temperatura me siguri ka qenë deri në 30, 40 qaty po. Fëmija vjellshin, po ja boj atij shoferit, "Çeli bre dritaret". Tha, "Jo, jo nuk guxoj m'i çelë dritaret". Na çunë me një vend u thirrke Mojane, u thirrshin Kodrat e Gjarpinjëve, Kodra e Gjarpinjëve. Aty ish konë KFOR-i²⁴ anglez me ato çadrat e tyne aty krejt komplet. Zbritëm aty. Do çadra t'gjona po shumë t'shkurta aty, t'shkurta. Ata na dhashin çokollada, biskuita dhe qumësht edhe ujë, tjetër send kurgjo edhe bukë të thatë me konzerva. Ja nisë popullata m'u bo krejt kaps.

Tash po shohin, çka po di unë, Bashkësia Evropiane. Vjen ni ekipë krejt e Turqisë, Demir Eli u thirrke, kryetar i turqve Demir Eli, me helikopter ka zbrit bash në kampin tonë. Aty ka zbrit, e ka pa situatën qysh osht!. Mas dy ditë kenë krejt kuzhinat komplet. Kena pasë në mëngjes gjana, supë e kto sendet me mish e me krejt edhe drekë e darkë e krejt. Atëherë, {kollitet} m'falni, atëherë u kry, shumë mirë u bo, po m'u pastru s'kishim ku.

Çka me bo unë, shkoj n'qytet. Po thotë gruja, "Ku po shkon? Të shtijnë n'burg". "Valla le të m'shtijnë ku të donë". U veshë, u rruva, shkova në kojshi aty ni shqipëtar, "A bon bre t'pastrona?" "Po more, pse jo". U pastrova, dola në qytet, unë me Arbër Xhaferin jena konë shokë gjatë studimeve në Beograd. Po i thom, t'shkoj atje në seli të tina. Kur shkova atje, shkova në Shkup atje, drejt hina mrena. Tha, "Çka po kërkoni?" Ai rojtari. Thashë, "Po du me Arbër Xhaferin me bisedu". "Shiqoni", tha, "Arbëri ka shku në Shtetet Arabe dikund u shku. Po çka po t'vyn?" Thashë, i kom puntë qeshtu, qeshtu, qeshtu, "Ëhë, mirë!" Tha, "Sa vetë jeni?" Unë isha, unë, shoqja edhe djali, a vllau e kish shoqen vet edhe ni re me veti, pa fmi, gjashtë vetë. "Valla Hysni" tha "veç ty kisha mujt, në qytet du me t'gjetë diçka." thash "Jo, jo, jom me vlla. S'ka kuptim". "Ani".

Na çunë në një fshat u qujke Sfillare. Aty kena nejt valla njo ni muj gati. Aty kena nejt në atë t'veten ai na ka prit mirë na ka prit, ish konë i varfun gjynahit shumë. Tha, "Shqio, unë mjell kom." Thashë, "Ti mos u bo gajle. Neve na vyn, a din çka? Ujë edhe strehimi. Kurgjo tjetër". Na gjeti ni dhomë aty,

²⁴ Forca e Kosovës është një forcë paqeruajtëse ndërkombëtare e udhëhequr nga NATO në Kosovë. KFOR hyri në Kosovë më 11 qershor 1999, dy ditë pas miratimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB.

flejshim me vllaun qaty komplet tonë. Ni muj ditë kena nejt qaty. Mas ni muj dite na erdhën letrat prej Londrës, prej Londrës edhe ... pak emocione kom (qanë).

Meniherë i kemi përgatit rrobat, valigjet që i kena pasë, s'kena pasë shumë na. Kena pasë shumë ai Kryqi i Kuq që na ka dhonë, po asnjë s'e kena marrë na. Krejt ia kena lonë atij aty, kurgjo s'murrëm hiç. Aty i kemi përgatitë valigjet edhe kemi shku në një autobus. Autobusi na ka çu në aeroport, prej aeroportit aty na kanë thonë, "A osht' dikush i smut?" M'tha shoqja, "Mos thuj që jom i smut se bon vaki s'na lshojnë". Thashë, "Po, mirë jemi, krejt mirë jemi".

Jemi hyp në aeroplan kemi shkru në Lic. Kur kena shku në Lic, ata na kanë prit pos tepihu i kuq që s'u konë, a beson? Kur kena hi në një sallë të madhe, plaka 70-80 vjet na shërbejke, merre me mend, m'ardhke keq, gjynah. Na prunën supa, bukë, cigare, sende, ma qiten paqetën e cigareve mu. Tha, thashë, "Unë s'e pi cigaren". U çuditën. "Qysh s'e pin ti cigaren?" Krejt pishin. Thashë, "Kurrë s'e kom pi". Qaty kena prit, kena nejt, na kanë gjetë dhomat, dhomat na gjetën me flejt. Si jena hi mrenda aty ish konë ni çantë aty në rrugë me sende të femrave. Tha, "Qe qikjo osht' dhoma e juve", shoqja tha "Jo, koka e zonme", "Jo, jo" tha "nuk osht' e nxonme. Kjo osht' çanta për ty". Atëherë jena vendos aty, mrenda dy dite na kanë ardhë edhe fëmija, po. (qan)

Erëmirë Krasniqi: I madhi ju paska shku në Greqi.

Hysni Krasniqi: Po, në Greqi.

Erëmirë Krasniqi: A i erdh atij naj letër me shku në ushtri, a qysh?

Hysni Krasniqi: Jo, atij s'i ka ardhë, ai e ka kry. Qe shiqo, po të tregoj, ai e ka kry një Njesi Speciale kundër aeroplanave, e lypshin për me shku ushtarë edhe ky nuk shkoi. Thashë, "Bir ti s'bon me shku si ushtar kurrsesi hiç". Ai në Lublanë e ka kry ushtrinë. Saqë ma bojke kojshia serb, "Qysh e gjete ti fëminë me çu në Lublanë?" Thashë, "S'e kom gjetë, shteti e ka çu, jo unë". E pata gjetë një lidhje aty, këtë Xhehal Qehaja e kom pasë njoftë pak me to edhe shkoi atje e kreu. Edhe i thashë, "Bir gjithëqysh me shku". Shkoi në Greqi, dul në Greqi, atëherë mujshim me dalë shumë lehtë. Prej Greqisë tani ka shku në Francë, ka nejt te vllau ni kohë të gjatë.

Anglishtën e kanë ditë, të dytë ujë e kanë ditë. Edhe kanë shku aty kanë nejt disa ditë e ka çu deri në këtë kanal La Mansh. Aty ka hyp, e ka marrë një çantë kështu, u hi mrena, ka dalë në atë anë. Kur ka dalë ka thonë, "Unë du azil politik". Ka marrë azil edhe e ka fillu jetën e tij. Me ditë anglishtën e ka ditë, nuk ka dashtë m'i marrë ato ndihmat që i marrin, ka thonë, "Unë du punë, unë e di anglishten". Kanë gjetë punë, kanë gjetë punë përkthyes te kta që kanë ardhë si refugjat, a ku ta di unë. Sot e asaj dite hala punon qashtu. Tash punon në shpi, i merr fëmity, i merr të huj e anglezë, çka s'vijjnë aty, qysh thojnë atje, nëse osht' fëmija problem e sene. Familjen e largon edhe i manë ai aty, katër fëmijë i ka aty. E ka shpinë, e ka ble shpinë e vet e ka, gjashtë dhoma i ka, po. E qeshtu.

Kurse këtë të dytin, ky i dyti kur ka shku, ka shku n'mes të Gjermanisë, në mes të Gjermanisë e kena pasë ni shok të mirë, shumë të mirë. Këtu ka hyp në autobus, e gjetëm një agjencion që e çon deri në Gjermani pa kurrëfarë problemi. Ka shku aty. Ai shoku jonë i shtëpisë që veç që s'ka flejt, fëmija gjithë me to kanë nejt bashkë, e ka çu gjithashtu edhe ato deri në Kanalin e La Manshit prej Gjermanisë. Ky e ka ditë anglishtën për mrekulli, ky i vogli edhe qashtu sot e asaj dite e din. E ka marrë ni gazetë angleze...

Erëmirë Krasniqi: Në cilin vit ky?

Hysni Krasniqi: Po, pasha Zotin, para...

Erëmirë Krasniqi: Para lufte a?

Hysni Krasniqi: Para lufte, para lufte, shumë para lufte.

Erëmirë Krasniqi: Jo të Kosovës, po mendoj para luftave të Kroacisë e Bosnës a...

Hysni Krasniqi: Jo, të Bosnës, të Bosnës se e pajsha që ajo luftë do të vjen tek na edhe ka hyp e ka marrë ni çantë të vogël, ai i vogël u konë bre i vogël. I ka pasë, a din sa i ka pasë? I ka pasë 16 vjet, as 17 s'i ka pasë bile. A kur e kom qitë ato shumë keq e kom ndi veten, po. E qita në autobus edhe krejt shokët e klasës edhe krejt shoqet e klasës e përcullen. Shkoi edhe ka hyp, e ka qitë tash ai shoku në tren në La Mansh. Kanë hi i kanë thonë, hiç kërkush s'i kanë lyp kurgjo, veç biletën ja kanë lyp, se kur e kanë pa që po lexon anglisht, kanë thonë ky sigurisht, veç biletën ja kanë lyp. Ja ka dhonë biletën, ama kur ka hi në kufi aty e ka qit pasaportën. Kta i kanë thonë, "Pasaporta osht' fallc", tha "Po valla, fallc osht, e vërtet o, fallc o", "Pse?" "Pse?" Tha, "Kom ikë prej lufte".

Atëherë u konë vllau i vet aty, se përpara ka shku i madhi. Ka thonë, "Na kërkujmë", se faktikisht ai e ka marrë avokatin, azil politik edhe kto. Edhe ky u hi aty në Angli. As ky s'ka dashtë me marrë ndihma edhe ky ka punu meniherë. Kanë gjetë punë, kanë gjetë punë nëpër kafe ktu. Sot e asaj dite osht' menaxher, menaxher i ni kafe shumë, shumë me rëndësi. E madhe osht' ajo kafe, krejt osht' ai, krejt përgjigjet me t'gjitha, me material, me rroga, me tonat, po. Punojnë ata, të dytë mirë jonë, të martum jonë, të tretë i kom të martum, kanë fëmijë. Qeshtu puna e tyne, tash jetojnë, mirë jonë ata, mirë jonë shumë. Na ndihmojnë, na ndihmojnë shumë.

Erëmirë Krasniqi: Domethonë, gjatë luftës mandej ju u takut me djalin e madh edhe t'voglin.

Hysni Krasniqi: Tani gjatë luftës ata, ata, mas luftës me të vëertetë. Gjatë luftës u takum ne Lic, në Lic.

Erëmirë Krasniqi: Po.

Hysni Krasniqi: Prej Licit, atëherë na dojshim, thamë shiqo, "Ju duhet me marrë një shpi edhe me nejt në një shpi". Thashë, "Unë du me fëmijë me nejt". Ata fëmija ardhshin për çdo ditë na pajshin kogja larg, kilometra të mdhaja edhe po e shohin ata, s'hankshin bukë aty. Thanë, "Shiqo, prej sotiti e keni

edhe ni dhomë edhe fëmija kanë me flejt ktu edhe kanë me hangër bukën ktu. Kanë me nejt me prind”. Na s’di sa s’kishim qef qashtu na fort me qenë ngarkesë e tyne. “Na”, thashë, “dojmë me shku me fëmijë m’u bashku në Londër”. Atëherë e murrëm ni autobus, si familje autobus, na murrën na çunë në Londër deri në banesë të atyne. Atëherë u vendosëm aty, kom nejt rrafsh ni muj ditë unë, mo s’mujsa me nejt. Shoqja me gjithë djalë kanë nejt, ktu veç ia filloj tani...

Erëmirë Krasniqi: M’u normalizu...

Hysni Krasniqi: Po, m’u normalizu. Studentat thojshin m’u kthy shok profesor, se e kanë marrë vesh, ku me ditë qysh kanë marrë adresat.

Erëmirë Krasniqi: Kur u kthyt ju?

Hysni Krasniqi: Unë jom kthy në ‘99-shin, në të vërtetë në vitin ‘99 në fund të shtatorit. Po qysh u ktheva, unë ja qita ni lutje Bashkisë të Arsimit atje. Unë thashë du m’u kthy, ai thojke “Ku po shkon ti? Atje osht’ luftë hala, s’keni ku fleni, s’keni çka hani, s’keni çka pini, ka mina.” Thojshin, gjithëçka na bojshin. “Na ju kena pranë ni vit. Prej ni viti qiteni lutje pesë vjet e tani vazhdon apet. Qe po ja u jepim shpinë.” Thashë, “Shumë faleminderit, ju na keni strehu mjaft”. Edhe m’lejunë. Tha, “Aeroplani i parë që shkon për Kosovë, ti përgatite valigjen”. Edhe qashtu ndodhi.

Kur erdha ktu unë, ata thojshin atje, “Ndërtesa juve është rrënu” e sene ku ta di unë.

Erëmirë Krasniqi: Qysh e gjetët shpinë?

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Qysh e gjetët shpinë?

Hysni Krasniqi: Banesa ish’ konë në rregull krejt, domethonë s’është e rrënume, por ku jom hi mrena qeshtu, e shihni edhe në fotografi ju krejt. Krejt të vjedhme çka ka, me televizora, me radio, me gramofona, me aparata, me grafika, me mjete të punës. Krejt mjetet e punës vjedh m’i kishin, krejt. I shifni edhe vetë qitash në fotografi, krejt vjedh i kishin. M’i kishin marrë rrobet kryesore. Po ato s’i kanë vjedh bre kta, serbi s’e merr gotën e çajit, as s’e merr filxhanin e kafës. Katër herë e kishin thy banesën. Katër herë banesën thy ma kishin.

U ktheva, hina mrena, çka me pa? Krejt qeshtu llom. Unë u tuta me hi, po ta thom të drejtën. I thirra kta të KFOR-it që jonë me do aparata e shiqun, sa që edhe në tualet hinën e shiqun. “Mos u tut se s’ka kurgjo ktu, puno lirisht, qiti senet nëpër vende të veta”, po ku me ia nisë ma përpara s’disha, a rrobat, a atelenë me rregullu? Veç kadal kadal. M’i dhanë 720 marka ata.

Erëmirë Krasniqi: Funta...

Hysni Krasniqi: Funta. Jo, jo, marka m'i dha, jo funta. Tha, "Pse funta?" Tha, "A marka shkon atje." Edhe ni paketë ushqim thatë, kështu diçka gjatë rrugës për aeroplan. Erdha ktu, ia fillova me metë gjallë. Prej fillimit i rregullova qashtu sendet. Mas ni kohe, mas njo ni muj dite erdhën edhe shoqja me gjithë djalin.

Erëmirë Krasniqi: Qysh e murret lajmin për vllaun?

Hysni Krasniqi: Na e kena marrë lajmin kështu, kojshia që ardhshin...

Erëmirë Krasniqi: Ëhë, sa ishit ktu...

Hysni Krasniqi: Që kanë qenë ktu, po të ardhun në Maqedoni, thanë vllaun ta kanë vra, e motra tu ikë thanë prej ktyne idiotave te Sharra. A pe din ku o Sharra? Tu ikë aty e ka kap infrakt edhe qaty e kanë shti, meniherë në dhe e kanë shti, ka qenë një pishinë noshta e dini. A e din atë pishinë përpara kur ka qenë? Qaty u konë. Kur kena ardhë na prej Londrës, kena ardhë edhe e kena nxerrë na prej dheut, e kena ç'vorros unë, dy djelmte e motrës edhe ni kushëri. Na të katërtit jena konë, e kena qit n'kerr, e kena varros në Mramor, se në Mramor i ka pasë djemtë. Qeshtu ka qenë. Na thojshin valla osht' në Tetovë, ktu, tash na hishim në kompjuter aty, e shiqojshim, qiky emër nuk o ktu kërkund, nuk osht' e vërtetë. Tani ma vonë e ditëm ku osht'. Tani kena pasë problem qysh me gjetë, menxi që e kena gjetë, veç eshnat, meqë i gjetëm ktu nëpër Velani, dikund atje në...

Erëmirë Krasniqi: Për vllaun e keni fjalën që e keni gjetë tash...

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Konë e keni gjetë?

Hysni Krasniqi: Vllaun, veç eshnat çka ja gjetëm, kurgjo tjetër. Ni grup francez atëherë, as nuk lejojshin me çelë, vetëm në llastik ishte. Tha, "Ku e njuh ti që e kom vlla?" Thashë, "E njoh shumë mirë edhe në kufomë." Tha, "Qysh e din?" "E ka pasë kamën e majt të thyme gjatë skijimit edhe ka dhomtë të dukatit", thashë. "Po", tha. Edhe atëherë na lshun. Qeshtu ka qenë puna.

Erëmirë Krasniqi: Mandej u kthy gruaja me djalin?

Hysni Krasniqi: Mandej u kthy gruaja, ia fillum jetës përsëri. Hini në punë ku ka qenë shoqja, ka qenë kontrollore në Postë, ka fillu punën edhe unë fillova në Fakulltet tani punës, kemi fillu qeshtu jetën. Gradualisht tani i kena bo t'gjitha, prapë i kena bo t'gjitha.

Erëmirë Krasniqi: Kur ja nisët tani apet me krijju?

Hysni Krasniqi: Krijimi ka shku pak ma vonë, ma vonë pak se na hala i kom ato farë traumash ato, po kur m'vijne ato i iki asaj ja nisi me punu diçka me harru, me harru po thom t'drejtë. Krejt qito jonë, qeshtu ka qenë puna jonë. Pa shiqo, ishalla osht' ma s'pari mos u harroftë edhe mos u përsëritë kurrë,

kurrë. Në Zot, po! Ti a po e sheh çfare osht' qeveria? Po e sheh. Veç qiky në t'mujtë me bo diçka. Ishalla bon diçka.

Erëmirë Krasniqi: Dita e Pavarësisë a ju kujtohet?

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Dita e Pavarësisë...

Hysni Krasniqi: Po m'kujtohet shumë, au ajo ka qenë, ka qenë...

Erëmirë Krasniqi: Qysh ja ka nisë ajo ditë për juve?

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Qysh ja ka fillu ajo ditë për juve?

Hysni Krasniqi: Për mu ka qenë ajo një barrë e madhe që u patë hjekë edhe ni gzim i madh, u doke që po lulzojmë, po përtrihemi, po vjen një jetë e re për neve. Ashtu e kom ndje veten po ta thom të drejtën, po a pe sheh nuk jonë t'u shku në rrugë të drejtë, njoni knej njoni...

Erëmirë Krasniqi: Çka keni bo atë ditë?

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Çka keni bo atë ditë, a keni dalë a...

Hysni Krasniqi: Po kem dalë, kem dalë na, kem festue si t'gjithë po ta thom të drejtën. Po shiqo, jom ni tip që fort nuk i adhuroj shumë festat ashtu, e marrë diqysh nifarë rezerve, me rezervë e marrë çdo send, çdo send e marrë: si t'keqen, si t'mirën e marrë njejtë diqysh, a din. Njejtë e marrë me rezerva çdo send, po ta thom të drejtën. A e di çka osht' gzimi, e di çka osht' idhnimi, tonat i di, po e marrë, t'kufizime e marrë, shumë me nifarë kufizimi i marrë, se disi edhe nuk osht' ajo mirë. Për shembull, m'u çmend aty, m'u çfrenue, me dalë prej kornizave njerëzore. Njeri duhet me qenë gjithëherë i vetëdijshëm çka bon edhe çka vepron, si në rrugë, si në shpi, si kudo duhet me pasë vetëdije.

Disa, çka po qet armë? Çka po qet armë? Ti ki pasë kohë kur u duhtë me qit armë, por jo në liri, jo në darsëm. Ti festo me zo, jo me armë. Çfarë primitivizmi osht' ajo me qit me armë *bim bim bim* {onomatope}. Çka osht' ajo, tregom? Ajo osht' po ta thom të drejtë në atë mënyrë, diqysh i del psikës të njeriut, del ajo krejtsisht.

Erëmirë Krasniqi: Unë nuk kom mo pyetje tjera, po...

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Unë nuk kom pyetje tjetër, po nëse ju keni pyetje, jo pyetje po naj, nëse kishim mujt me plotësu këtë intervistë rreth krijimtarisë të juaj. Nëse unë nuk kom ditë diçka me ju pytë juve, po mendoj që është ai moment që kishit mujt me fol pak ma detajisht.

Hysni Krasniqi: Kom fotografitë.

Erëmirë Krasniqi: Ato i kqyrim pas intervistës, ajo është diçka që shikohet...

Hysni Krasniqi: Shiqo, unë me ta thonë të drejtën unë kom pasë mundësi shumëçka me kriju, shumë, shumëçka, po kom qëllu në një shoqni që m'u nuk m'ka kuptu. Unë kom pasë qaq energji edhe kom pasë energji pozitive, jo negative, po nuk kanë lonë njerëzit. A po e sheh përpara sportistat numër ni kurrë s'i kanë lonë me përparu, ja u kanë nalë hovin, ja u kanë nalë. Pikë së pari studentit tem i kanë dhonë atele, mu nuk m'kanë dhonë atele. Pse nuk m'kanë dhonë atele? Se s'kom qenë në dorën e tyne. Unë s'jom dorë e kërkujt, unë jom dorë e imja edhe e popullit tim, jo dorë e ndonjë dogme t'keqe që punon kundër shoqërisë, kundër popullit. Asniherë nuk jom hi në dogma të kërkujt hiç, se e kom pa që nuk osht' në rregull ajo, nuk o n'rregull ajo.

Egoizmin e urrej. Tri sene të jetës i urrej: rrenën, hajninë edhe tradhëtinë, këto jonë për mu sendet ma të qkija që ekzistojnë, po. Rrena bohet, dihet ku bohet, për atdhe, për atdhe bohet rrena e jo për gjithçka, për pasuni, m'u pasunu ti vet, me rrejt.

Erëmirë Krasniqi: Diçka për juve, për punën e juve që s'kom ditë me ju vetë?

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Diçka rreth punës së juaj që s'kom ditë me ju vetë.

Hysni Krasniqi: Po puna jeme osht', po shiqo osht' shumë me ta thonë të drejtën, unë lidhna me natyrën, e du natyrën shumë, e du natyrën taman ekologjike, jo me mbeturina. Unë kur po shoh, çka po shoh me kta dy sytë e mi kur po i qesin në kta televizor kur po i gjojnë aq ato ndytësira, paj ajo osht', shiqo, katastrofa ma e madhe e popullit tonë osht' ajo.

Erëmirë Krasniqi: Inspirimet ku i keni pasë?

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Inspirimet...

Hysni Krasniqi: Inspirimi, inspirimi jem ma s'shumti osht' në natyrë. Unë e marrë një fragment nga natyra edhe e përjetoj, e përjetoj me shpirt edhe me zemër edhe e qes ose në letër ose në material ose në pëlhurë. Ajo për mu osht' kreyesorja. Nuk jom tip që boj shumë figura, boj portrete që kanë vujt diçka, kom disa portrete ashtu gjatë luftës që ja u kanë çallamit kryt, që ja u kanë bo, i kom bo disa.

Kom pasë mundësi shumëçka me bo, po ma kanë ndërpre atë hovin ma të madh që e kom pasë, po. Ajo osht' me randsi.

Për shembull, unë i kom “Grunajat”. Pse i kom grunajat? Grunajat, populli jonë ka vujt për kafshore goje, ka vujt për kafshore goje. I kom pastaj “Trinat”, trinat. Çka jonë trinat? Trinat jonë mjet i cili gjithëherë bujku i ka përdorë, si me rrafshit tokën, me llaqit tokën që thojnë, si me terë pemë, perime me terë, qato jonë trinat, si me mbrojtë atëdheun, si me mbrojt oborrin e shtëpisë, ato jonë trinat. Qato i kom pasë.

Pastaj i kom “Xixëllonjat”. Çka o xixëllonja? Xixëllonja osht' lajmëtari i parë që ka dalë, duku i parë në Kosovë, në tokë të bukës. Atëherë e kanë ditë që na jena dalë në bukën e re, qajo osht' xixëllonja. Ajo me atë feniksin kur bon *cik cik* {onomatope} ajo tregon që osht' ardhë kona me korrë dikun, e qito. Tani kom “Lulet e kujtimit”, ai vendi i jem ku kom lindë unë aty në Llukar, ma shumë kom nejt në Prishtinë. Në vendlindje aty osht' krejt me lule, lulebore, lule thishte, lule vjollce. Po çfarë ere ka lule vjollce, po osht' diçka e pabesueshme, sikurse mu konë nifarë ese e ni parfimi, që unë s'i qes ato kurrë, veç pos rrojës e boj. Qaq ka, tani osht' nifarë bari thirret Elmetum, ndoshta ke ndëgju? Ajo osht' ni bari që dy copa gjethe ja shtin fëmijës ktu në kry, flen meniherë, kënaqet. E ka një erë të kandshme e ka. Qito sende më inspirojnë, toka, toka me gjelbrim, toka e pastër, gjethet, kto jonë inspirimi, po...

Erëmirë Krasniqi: Shumë faleminderit.

Hysni Krasniqi: Me nder qofsh.

Erëmirë Krasniqi: Këtu po e mshelim intervistën.

Hysni Krasniqi: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Këtu po e përmbyllim intervistën.

Hysni Krasniqi: Po si të doni ju, si të doni, unë çka të di ju tregoj...